



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 316 Akti

Nr. 415 Vendimi
Tiranë, më 7.7 2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Tonçi Petkoviç, në datën 5.7.2021, ora 15:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Saimir Smaka**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, subjektin e rivlerësimit, z. Saimir Smaka, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Tonçi Petkoviç, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike, në tërësinë e tij, vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Saimir Smaka, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Saimir Smaka, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 12.11.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Olsi Komici dhe Suela Zhegu. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Olsi Komici.

3. Me vendimin nr. 1, datë 18.11.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Saimir Smaka, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisionere Genta Tafa (Bungo). Në respektim të legjisllacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Tonçi Petkoviç.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim, Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, DSIK) dhe Grupi i Punës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

5. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 24.6.2021, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Saimir Smaka, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 24.6.2021 mbi përbërjen e trupit gjykues, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfuara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

8. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, në datën 1.7.2021 ka dërguar nëpërmjet postës elektronike prapësimet, si dhe provat në lidhje me rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike, në datën 1.7.2021.

10. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, datë 5.7.2021, ora 15:00, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonçi Petkoviç.

11. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht, parashtroi shpjegimet e tij, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, z. Saimir Smaka, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

12. Z. Saimir Smaka ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, por nuk ka dhënë shpjegime për të gjitha problematikat, për të cilat Komisioni i ka ngarkuar barrën e provës. Për një pjesë të tyre ka dhënë shpjegime vetëm gjatë seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

14. Për subjektin e rivlerësimit, z. Saimir Smaka, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

15. Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë

vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

16. ILDKPKI-ja, me shkresën nr. ***, datë 26.6.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Saimir Smaka, i cili është subjekt deklarues pranë këtij institucioni që prej vitit 2013, me numër indeksi ***, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

17. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private në periudhën 2013 – 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë më 25.1.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për çdo pasuri të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues për banesën e deklaruar nga babai i subjektit;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

18. Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- b) deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- e) deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore, etj.

19. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje

me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

20. Në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë, shtojca 2, në zbatim të nenit 31/1¹ të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Saimir Smaka, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të) në datën 25.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

➤ **Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *Vetting***

1. Llogari rrjedhëse me nr. *. Vlera: 365,403 lekë. Pjesa takuese: 100%**

Burim i krijimit: nuk është deklaruar burim i krijimit të kësaj llogarie.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

1.1. Nga shqyrtimi i dosjes *Vetting*, Komisioni vëren se kjo llogari nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës së vitit 2013, as në deklaratën e interesave pasurore periodike të vitit 2013 (DIPP në vijim) dhe as në DIPP-në e vitit 2014.

1.2. Nga korrespondenca me “Raiffeisen Bank”^{2/3} konfirmohet llogaria rrjedhëse e pagës në shumën 365,403.33 lekë në emër të subjektit të rivlerësimit. Kjo llogari është hapur më 6.11.2007 dhe duke filluar nga viti 2011 është kredituar bursa nga Shkolla e Magjistraturës, kurse nga dhjetori i vitit 2013 janë kredituar pagat si prokuror. Gjithashtu, në këtë llogari janë disbursuar edhe kreditë bankare të marra nga subjekti i rivlerësimit, konkretisht: disbursuar më 10.8.2015, kredi në shumën 312,000 lekë; më 11.1.2016, kredi në shumën 53,000 lekë, më 19.7.2016, kredi në shumën 239,700 lekë, më 8.6.2018, kredi në shumën 300,000 lekë.

1.3. Referuar veprimeve në llogarinë bankare, vihet re se për periudhën 22.8.2014 – 2.10.2015, subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në këtë llogari shumën 1,719,000 lekë.

Data	Përshkrimi	Vlera
22.8.2014	SAIMIR SMAKA DERDHJE NË LLOGARI	74,000.00
1.9.2014	SAIMIR SMAKA DERDHJE NË LLOGARI	134,000.00
24.10.2014	SAIMIR SMAKA DERDHJE NË LLOGARI	511,000.00
6.1.2015	SAIMIR SMAKA DERDHJE NË LLOGARI	146,000.00
23.1.2015	SAIMIR SMAKA DERDHJE NË LLOGARI	104,000.00
20.2.2015	SAIMIR SMAKA DERDHJE NË LLOGARI	90,000.00

¹Subjekti i rivlerësimit ka detyrim të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

²Vërtetim nr. ***, datë 26.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”.

³“Raiffeisen Bank” me nr. *** prot., datë 29.1.2020.

8.5.2015	SAIMIR SMAKA DERDHJE NË LLOGARI	350,000.00
11.8.2015	SAIMIR SMAKA DERDHJE NË LLOGARI	210,000.00
2.10.2015	SAIMIR SMAKA DERDHJE NË LLOGARI	100,000.00
Total		1,719,000.00

1.4. Nga kjo llogari, në datën 24.8.2015 është tërhequr *cash* shuma 620,891 lekë dhe më 1.12.2015 është kaluar në depozitë me afat shuma prej 1,000,000 lekësh, e krijuar si gjendje në llogarinë e pagës nga depozitimet *cash* të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

1.5. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 20.11.2015, kur është pyetur në lidhje me depozitimet *cash* në këtë llogari bankare (përveç pagës) gjatë vitit 2014, subjekti ka shpjeguar se kanë si burim të ardhurat që babai i tij ka marrë nga qiratë e tokave bujqësore që ka përfituar me ligjin nr. 7501. Këto të ardhura, babai ia ka lënë subjektit për t'u administruar, pasi vetë është i sëmurë me kemp. Gjatë vitit 2015, një pjesë e likuiditeteve në bankë janë përdorur së bashku dhe me një kredi të marrë në vlerën 300,000 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* AMTP-në e datave 29.8.1995 dhe 31.7.1995, në emër, përkatësisht, të babait të tij Z.S. dhe nënës S.S., certifikatat familjare të datave 1.8.1991, 1.10.1992 dhe 17.12.2014 dhe certifikata e pronësisë së tokës datë 7.5.2015, në emër të babait.

1.6. Në pyetësin nr. 1, subjekti është pyetur nga Komisioni nëse ka përfituar të ardhura nga qiraja apo të ardhura të tjera dhe nëse janë paguar detyrimet tatimore për to. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se që nga momenti që ka filluar detyrën si prokuror nuk ka marrë vlera qiraje të tjera në emrin e tij.

1.7. Subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar qiratë nga tokat bujqësore në deklaratat e interesave private periodike. Për këtë, në pyetësin nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit që: (i) të provojë me dokumentacion ligjor marrëdhënien e qirasë për tokat bujqësore, duke përfshirë edhe pagesat e vlerave të qirasë nga qiramarrësit; (ii) të shpjegojë mosdeklarimin në DIPP-të e viteve 2014 dhe 2015 të të ardhurave nga dhënia me qira e tokave bujqësore dhe nëse ka realizuar të ardhura nga qiraja e tokave bujqësore gjatë viteve 2013, 2016 dhe 2017; (iii) të provojë pagimin e tatim-fitimit mbi vlerat e qirasë të arkëtuara nga qiradhënia e tokave bujqësore.

1.8. Subjekti ka shpjeguar se për periudhën 2013 – 2015, ndërmjet nënës së tij S.S. dhe shtetasit Sh.M., është nënshkruar një marrëveshje me shkrim për dhënie me qira tokë bujqësore, ku shtetasi Sh.M. ka paguar qira në këstet 30,000 lekë për vitin 2014 dhe 50,000 lekë për vitin 2015. Nëna e subjektit është pajisur me deklaratë individuale vjetore të të ardhurave nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për vitet 2014 dhe 2015 dhe ka paguar edhe tatim-fitimin pranë këtij institucioni nëpërmjet “Credins Bank”, si dhe komisionet përkatëse. Në vijim, subjekti shpjegon se këtë marrëdhënie qiraje nuk e ka deklaruar për arsye se: (1) marrëveshja me shkrim për dhënie me qira të tokës bujqësore nuk ka karakter formal, publik, pasi është lidhur me shkrësë të thjeshtë; (2) prona nuk është regjistruar dhe nuk ka certifikatë pronësie, pasi zona ku shtrihet fshati Sh., Njësia Administrative L., Bashkia Fier, nuk është përditësuar plotësisht; (3) AMTP-ja është në emër të nënës së tij S.S., çka do të thotë se ajo është titullare e ligjshme e kësaj pasurie të paluajtshme dhe se në këto kushte, duke pasur parasysh karakteristikat e tokës bujqësore dhe familjes bujqësore nuk mund ta deklaronte si pasuri apo

pjesën takuese në të. Ndërkohë, subjekti vazhdon të shpjegojë se shuma prej 760,013 lekësh është nga kursimet nga paga e tij, shpërblimet e punës apo dieta sepse në kohën e dhënies së kësaj deklarate të gjithë anëtarët e familjes ishin babai (me kemp), nëna (marrëdhënie pune pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale Fier), subjekti (prokuror) dhe vëllai (inxhinier, specialist, shëf zyre në O.S.T.), kështu që kishte mundësi nëpërmjet kursimeve të tij të bënte derdhje të menjëhershme dhe të njëpasnjëshme pranë “Raiffeisen Bank”.

1.9. Bashkëlidhur shpjegimeve të pyetësorit nr. 2, subjekti ka depozituar këto prova pranë Komisionit: (i) marrëveshje qiraje datë 4.1.2013⁴, me qiradhënës S.S. dhe qiramarrës Sh.M. për dhënie me qira të pasurisë tokë arë me sip. 3900 m², e ndodhur në Sh., Levan, me afat 3-vjeçar. Vlera e qirasë do të jetë 30,000 lekë/vit dhe me nënshkrimin e saj është paguar shuma prej 50,000 lekësh për periudhën 12-mujore deri më 31.12.2015; (ii) deklaratën individuale vjetore të të ardhurave (DIVA) për vitin 2014 për znj. S.S., deklaruar më 5.5.2021. Të ardhurat *bruto* vjetore nga qiraja në shumën 30,000 lekë; (iii) urdhërpagesë për tatimin mbi të ardhurat individuale për vitin 2014, në shumën 16,419 lekë, gjeneruar nga sistemi tatimor më 6.5.2021; (iv) mandatpagesë në “Credins Bank” datë 6.5.2021, për shumën 16,719 lekë; (v) DIVA për vitin 2015 për znj. S.S., deklaruar në datën 5.5.2021; të ardhurat *bruto* vjetore nga qiraja në shumën 50,000 lekë; (vi) urdhërpagesë për tatimin mbi të ardhurat individuale për vitin 2015, në shumën 9,777 lekë, gjeneruar nga sistemi tatimor më 6.5.2021; (vii) mandatpagesë datë 6.5.2021, për shumën 10,077 lekë, në “Credins Bank”; (viii) vërtetim nr. 419, datë 5.5.2021, nga Njësia Administrative L. Fier dhe librezën e taksave dhe tarifave vendore, sipas së cilave znj. S.S. ka paguar taksat e tokës për periudhën 2011 – 2021.

1.10. Analizë financiare për mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të depozituar shumat *cash* në një total prej 1,719,000 lekësh në llogarinë e tij të pagës.

Referuar deklaramit të subjektit të rivlerësimit se si burim për derdhjet në llogarinë e tij bankare kanë shërbyer kursimet e tij personale, Komisioni mori në analizë pagat e përfituara nga subjekti deri në momentin e kryerjes së depozitimeve dhe shpenzimet individuale të paguara prej tij deri në këtë moment. Sipas analizës së mëposhtme duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën totale prej -943,338 lekësh për kryerjen e depozitimeve *cash* në shumën 1,719,000 lekë, për periudhën 22.8.2014 – 2.5.2015⁵.

Përshkrimi	01.01.2014-01.09.2014	02.09.2014-24.10.2014	01.01.2015-06.01.2015	07.01.2015-23.01.2015	24.01.2015-20.02.2015	21.02.2015-08.05.2015	09.05.2015-11.08.2015	12.08.2015-02.10.2015	Totali depozitimeve cash
<i>Të ardhurat nga pagat në bankë</i>	691 911	188 727	0	94 363	88 195	273 184	303 007	174 294	1 813 681
<i>Detyrime - Kredi</i>	0	0	0	0	0	0	0	312 000	312 000
<i>Shpenzime</i>	297 465	68 937	0	28 846	37 434	88 313	116 373	84 496	721 864
Shpenzime jetike	146 665	30 137	0	10 446	18 034	47 313	58 373	31 952	
Shpenzime udhëtimi	30 800	8 800	0	3 400	4 400	11 000	13 000		
Shpenzime qiraje	120 000	30 000		15 000	15 000	30 000	45 000	30 000	
Shpenzime kredie								22 544	
<i>Pasuri</i>	208 000	511 000	146 000	104 000	90 000	350 000	210 000	728 155	2 347 155
Shuma të depozituara cash në bankë	208 000	511 000	146 000	104 000	90 000	350 000	210 000	100 000	1 719 000
Blerje mjeti 24.08.2015 (4500 Euro)								628 155	628 155
Mundësia për kursime (Të ardhura+ kredi pasuri-shpenzime)	186 446	-391 210	-146 000	-38 483	-39 239	-165 129	-23 366	-326 357	-943 338
Mundësia për kursime akumulative	186 446	-204 764	-350 764	-389 247	-428 486	-593 615	-616 981	-943 338	

1.11. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit:

⁴Marrëveshje midis palëve.

⁵Për depozitim të datës 6.1.2015, në shumën 146,000 lekë nuk janë marrë në konsideratë pagat e muajve nëntor-dhjetor 2014, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash* për vitin 2014, pra subjekti i rivlerësimit i ka shpenzuar tërheqjet e këtyre pagave në vitin 2014.

- nuk ka deklaruar llogarinë bankare dhe gjendjen e saj në DIP-në para fillimit të detyrës së vitit 2013, në DIPP-të e viteve 2013 dhe 2014, si dhe burimin e ligjshëm të vlerave monetare të depozituara *cash* në këtë llogari page, përkatësisht 719,000 lekë në vitin 2014 dhe 854,000 lekë në vitin 2015;
- ka deklarime kontradiktore lidhur me burimin e depozitimeve *cash* të kryera në llogarinë e tij bankare për periudhën 24.8.2014 – 2.10.2015, në shumën 1,719,000 lekë, pasi në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI deklaroi si burim të tyre të ardhurat nga qiraja e tokës bujqësore, kurse në pyetësor deklaroi kursimet e tij personale;
- nuk justifikon me burime të ligjshme financiare depozitim të shumave *cash*, në total prej 1,719,000 lekësh për arsye se:
 - a) nga analiza financiare mbi të ardhurat personale, duket se rezultoi me balancë negative prej 943,338 lekësh;
 - b) të ardhurat nga qiraja e tokës në shumën 80,000 lekë për vitet 2014 - 2015 duket se nuk janë të mjaftueshme për të justifikuar depozitimet *cash* në vlerën 1,719,000 lekë;
- nuk ka deklaruar marrëdhënien e qirasë dhe të ardhurat e përfituara, përkatësisht në deklaratat e pasurisë së viteve 2013 - 2016 dhe se pagesa e tatimit për të ardhurat nga qiraja për vitet 2014 - 2015 nuk është kryer në kohën e përfitimit të këtyre të ardhurave, por është bërë më 6.5.2021, pas depozitimit të deklaratës *Vetting*.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës që të japë shpjegime të shoqëruara me prova shkresore bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.12. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore nuk ka dhënë shpjegime lidhur me mosdeklarimin e llogarisë në DIPP-të e viteve 2013-2014 dhe mosdeklarimin e burimit të depozitimeve *cash* në vitet 2014 - 2015. Subjekti, në prapësimet e tij, nuk ka dhënë shpjegime për deklarimet kontradiktore të tij lidhur me burimin e depozitimeve *cash*.

Në lidhje me mosdeklarimin e marrëdhënies së qirasë, subjekti shpjegon se për periudhën 2013 – 2015 ndërmjet nënës së tij S.S. dhe shtetasit Sh.M. është lidhur një marrëveshje me shkrim për dhënie me qira të tokës bujqësore, ku shtetasi Sh.M. ka paguar qira në kështet 30,000 lekë për vitin 2014 dhe 50,000 lekë për vitin 2015. Në këto kushte, ndërmjet palëve është lidhur një marrëveshje verbale dhe se neni 826 i Kodit Civil kërkon regjistrimin e kontratave të qirasë së tokave bujqësore që janë lidhur me një afat mbi 9 vjet. Ndërkohë që të ardhurat e saj nga qiraja janë derdhur në llogarinë e subjektit të rivlerësimit “llogari rrjedhëse, depozitë pranë ‘Raiffeisen Bank’”, duke mos fshehur të ardhurat e ligjshme që burojnë nga kjo marrëdhënie juridike. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka shlyer të gjitha taksat në lidhje me këto toka bujqësore.

Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme të depozitimeve, subjekti ka shpjeguar se është me status beqar dhe nuk ka pasur detyrime familjare që të shpenzonte, madje as për prindërit e tij, sepse ata ishin në marrëdhënie pune apo kemp dhe kishin të ardhura. Gjithashtu, subjekti shpjegon se në periudhën 2013 – 2015 nuk ka pasur automjet personal dhe ka udhëtuar me mjete urbane Fier - Vlorë me bileta vajtje – ardhje, në vlerën 400 lekë. Për periudhën 2013 –

2016, subjekti shpjegon se ka marrë pagë në vlerën 3,300,000 milionë lekë, kështu që formalisht dhe potencialisht mendon se ka pasur mundësi t'i kursente ato para.

Vlerësimi i Komisionit

1.13. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të depozitimeve në shumën totale prej 1,719,000 lekësh në vitet 2014 - 2015, kjo për arsye se ai ka ndryshuar deklarinë në lidhje me burimin e ligjshëm, ku në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 20.11.2015 ka deklaruar si burim të ardhurat nga dhënia me qira e tokës bujqësore nga babai, kurse përgjatë hetimit administrativ ka deklaruar si burim kursimet personale nga paga.

Komisioni krijon bindjen se ndryshimi i burimit të krijimit të depozitimeve bankare në *cash* në vitet 2014 - 2015, gjatë hetimit administrativ të procesit të rivlerësimit, është bërë pikërisht me qëllimin për të justifikuar burimin e ligjshëm të këtyre depozitimeve dhe për këtë arsye vlerësoi të marrë në konsideratë deklarinë e subjektit në ILDKPKI sipas procesverbalit të datës 20.11.2015, duke e konsideruar si deklarinë të bërë përpara organit kompetent dhe të pandikuar nga procesi i rivlerësimit.

Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti i rivlerësimit është anëtar i familjes bujqësore dhe, për rrjedhojë, bashkëpronar në tokat bujqësore të përfituara në bazë të ligjit nr. 7501, "Për tokën", gëzon të drejtën ligjore të përfitojë edhe të mira materiale nga shfrytëzimi i kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar marrëdhënien e qirasë dhe të ardhurat e përfituara nga kjo marrëdhënie, në deklaratat e pasurisë.

Të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e tokës bujqësore nuk janë marrë në konsideratë në analizë financiare si burim i ligjshëm për krijimin e depozitave në shumën 1,719,000 lekë dhe për arsye, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe që të konsiderohen pasuri të ligjshme duhet të jenë paguar detyrimet tatimore. Rezulton se të ardhurat nga qiraja, përveçse janë në shuma simbolike (80,000 lekë në vitet 2014 - 2015), krahasuar me shumën e depozituar prej 1,719,000 lekësh, pagesa e detyrimeve tatimore në lidhje me këto të ardhura nuk është bërë në kohë reale kur janë përfitur këto të ardhura, por vetëm pas konstatimit të këtij fakti nga Komisioni, që do të thotë se është bërë vetëm për efekt të procesit të rivlerësimit dhe, si të tilla, këto të ardhura nuk do të merren në konsideratë nga Komisioni, kjo edhe në respektim të qëndrimit unifikues të mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në disa vendime të tij mbi të njëjtën problematikë⁶.

Edhe nëse do të marrim në konsideratë analizën financiare të kryer mbi mundësinë e subjektit për të krijuar depozitat në shumën totale prej 1,719,000 lekësh, me burim nga kursimet e tij nga paga si prokuror, subjekti i rivlerësimit përsëri rezulton me mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 943,338 lekë.

Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarinë të pasaktë, duke ndryshuar deklarinë e tij në lidhje me burimin e krijimit të shumës së depozitave prej

⁶Vendim nr. 8/2019 (JR), datë 16.4.2019; subjekti i rivlerësimit A.N., pika 63, paragrafi 3: "Për sa më sipër, tatimet e paguara gjatë procesit të rivlerësimit, për të ardhura të viteve 2006 - 2012, nuk e bindin trupin gjyqësor për ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, pasi duket qartë që kjo pagesë është bërë për efekt të procesit të rivlerësimit".

1,719,000 lekësh, duke deklaruar si burim fillimisht në procesverbalin e ILDKPKI-së në datën 20.11.2015, të ardhura nga dhënia e tokës bujqësore me qira dhe gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, kursimet personale nga paga.

Komisioni, duke marrë në konsideratë deklarin e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI në vitin 2015 se si burim për krijimin e depozitave kanë shërbyer të ardhurat nga dhënia me qira e tokës bujqësore në vitet 2014 - 2015, për shumën totale 80,000 lekë, si dhe faktin se nuk ka deklaruar burim krijimi të kësaj depozite as në DIPP dhe as në deklaratën *Vetting*, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pamjaftueshëm, duke rezultuar me mungesë të plotë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e depozitës në shumën 1,719,000 lekë.

2. Llogari rrjedhëse, depozitë nr. *, në shumën 1,000,080.33 lekë. Pjesa takuese: 100%**

Burim i krijimit: subjekti nuk ka deklaruar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj depozite.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

2.1. Nga korrespondenca datë 26.1.2017⁷, me “Raiffeisen Bank”, rezulton se kjo llogari është hapur më 1.12.2015, sipas kontratës së depozitës nr. ***, me afat 12-mujor, e lidhur më 1.12.2015, për vlerën 1,000,000 lekë. Subjekti e ka deklaruar këtë llogari edhe në DIPP-të e viteve 2015 dhe 2016.

2.2. Komisioni vëren se subjekti nuk ka deklaruar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj depozite.

2.3. Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjekti ka shpjeguar se gjatë kësaj kohe të gjithë anëtarët e familjes që kanë qenë në trung familjar me të, kanë qenë në marrëdhënie pune, babai ka krijuar të ardhura në formën e kempit, kurse subjekti nga ana e tij ka kursyer nga paga e tij, nga shpërblimet apo dietat e punës, pasi nuk ka pasur në pronësi automjet. Gjatë kësaj periudhe kohe nuk ka qëndruar në Vlorë, pavarësisht se ka marrë banesë me qira, por e bënë vajtje-ardhje me mjete (furgon), ku bileta e udhëtimit ka qenë në vlerën 200 lekë të reja. Gjithashtu, gjatë kësaj kohe ka kursyer nga paga e tij shpërblimet apo dietat e punës, pasi nuk ka pasur në pronësi automjet. Automjetin e parë e ka blerë në gusht të vitit 2015. Në këto kushte dhe rrethana, kur të ardhurat *neto* për të gjithë anëtarët e familjes rezultojnë rreth 220,000 lekë/muaj, sipas subjektit, ai ka pasur mundësi objektive që të rrisë kursimet vetjake, që të çelë një llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në shumën 1,000,000 lekë. Gjithashtu, në prapësimet e tij, subjekti ka shpjeguar se ka deklaruar në deklaratën *Vetting* depozitë në “Raiffeisen Bank” dhe se shuma në këtë depozitë është transferuar nga llogaria e pagës pranë kësaj banke.

2.4. Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti ka depozituar vërtetimet e pagës *bruto* të tij dhe të personave të lidhur me të (Z.S., babai, S.S., nëna dhe D.S., vëllai), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2018.

⁷Vërtetim nr. ***, datë 26.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”.

2.5. Analiza për burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj depozite është trajtuar në pikën 1, nga ku Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk justifikon me burime të ligjshme financiare krijimin e kësaj depozite.

Vlerësimi i Komisionit

2.6. Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se shuma në depozitë ka ardhur nga llogaria e pagës, por subjekti nuk ka provuar burimin e ligjshëm të shumave të depozituara në llogarinë e pagës (konstatuar nga Komisioni në pikën 1). Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime kontradiktore në lidhje me burimin e krijimit të derdhjeve bankare, pasi nga njëra anë deklaron dhe shpjegon se derdhjet janë bërë me kursimet e tij dhe nga ana tjetër deklaron se një pjesë e këtyre të ardhurave është siguruar edhe nga kursimet e prindërve.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë, duke mos deklaruar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj depozite, si dhe nuk arriti të provonte burimin e ligjshëm të krijimit të saj.

3. Automjet tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 2003, me targa *. Vlera: 4,500 euro. Pjesa takuese: 100%**

Burim i krijimit: nuk ka deklaruar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

3.1. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: “*Blerje automjeti tip ‘Mercedens-Benz C-Class’ viti 2003. Transaksioni kryer në gusht të vitit 2015. Automjeti regjistruar me targa ***. Vlera: 4,500 euro*”. Në DIPP-të e viteve 2016 dhe 2017 subjekti ka deklaruar: “*Blerje automjeti me kredi bankare në proces shlyerje, vit prodhimi 2003 me targa ****”. Në DIPP-në e vitit 2018, subjekti ka deklaruar: “*Shitje automjeti ***, vlera 3,500 euro*”.

3.2. Nga korrespondenca e kryer me ILDKPKI-në⁸ dhe DPSHTRR-në⁹ është vënë në dispozicion të Komisionit praktika e automjetit me targa ***, nga ku, ndër të tjera, rezultuan: (1) faturë shitje datë 27.7.2015, me shitës B... SPA dhe blerës E. T. për vlerën 2,300 euro; (2) akt zhdoganimi datë 2.8.2015 me eksportues B... SPA dhe importues E. T., vlera blerjes 2,300 euro; (3) kontrata shitje automjeti me targa ***, datë 24.8.2015¹⁰, me shitës E. T. dhe blerës S. Smaka, me vlerë 4,500 euro; (4) kontrata shitje automjeti me targa ***, datë 18.7.2018¹¹, me shitës S. Smaka dhe blerës R. K. për vlerën 3,500 euro.

3.3. Nga hetimi rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2015 dhe në deklaratën *Vetting* burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë automjet me targa ***.

Analizë e burimit të krijimit për blerjen e automjetit

3.4. Në DIPP-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar si burim krijimi për blerjen e automjetit me targa *** kredinë bankare në shumën 312,000 lekë. “Raiffeisen Bank” konfirmon kredinë bankare të disbursuar në datën 10.8.2015, në shumën 312,000 lekë.

⁸Shkresë nr. *** prot., datë 30.1.2020, nga ILDKPKI-ja.

⁹Shkresë nr. *** prot., datë 3.2.2020, nga DPSHTRR-ja.

¹⁰Kontratë nr. ***, datë 24.8.2015.

¹¹Kontratë nr. ***, datë 18.7.2018.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka shpjeguar se burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa *** janë siguruar nga kursimet nga paga si prokuror dhe një kredi në “Raiffeisen Bank” në shumën 312,000 lekë, në datën 10.8.2015. Bashkëlidhur shpjegimeve të tij, subjekti ka depozituar kontratën e kredisë datë 10.8.2015, me vlerë 312,000 lekë dhe kontratën datë 24.8.2015 të blerjes së automjetit me targa ***, me vlerë 4,500 euro.

Komisioni kreu analizën financiare për mundësinë e blerjes së automjetit në datën 24.8.2015, me burim kredinë bankare dhe kursimet nga të ardhurat e pagës.

Përshkrimi	1.1.2015-24.8.2015
<i>Të ardhurat nga pagat në bankë</i>	758,749
<i>Detyrime - kredi</i>	312,000
<i>Shpenzime</i>	307,197
Shpenzime jetike	144,397
Shpenzime udhëtimi	30,800
Shpenzime qiraje	120,000
Shpenzime kredie	12,000
<i>Pasuri</i>	1,145,859
Ndryshim likuiditeti	517,704
Blerje automjeti më 24.8.2015 (4,500 euro)	628,155
Mundësia për kursime (të ardhura+ kredi pasuri-shpenzime)	-382,307

3.5. Nga analiza financiare, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme për blerjen e automjetit në datën 24.8.2015, pasi rezulton me balancë negative në shumën 382,307 lekë. Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i kaloi subjektit barrën e provës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

3.6. Në prapësimet e tij, subjekti i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit se nga shuma totale prej 4,500 euro e shpenzuar për blerjen e këtij automjeti në datën 25.8.2015, 312,000 lekë janë siguruar nga kredia bankare me “Raiffeisen Bank” (konvertuar sipas kursit të këmbimit valutor në vlerën 2,500 euro) dhe pjesa tjetër prej 2,000 euro e siguruar nga kursimet prej pagës si prokuror, duke depozituar si prova një vërtetim për të ardhurat gjithsej dhe pagën *neto* të tij, si punonjës pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe një *statement* mbi gjendjen financiare të tij.

Komisioni, pasi mori në konsideratë shpjegimet e subjektit, si dhe provat e siguruara gjatë hetimit administrativ, arrin në përfundimin se:

- Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, duke mos deklaruar në DIPP-në e vitit 2015 dhe në deklaratën *Vetting* burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë automjet me targa ***.

- Subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën - 382,307 lekë për të justifikuar blerjen e këtij automjeti.

4. Pasuri të llojit “arë” me sip. 1840 m² dhe me sip. 880 m², përfituar me ligjin nr. 7501/1991

- a) **Tokë me sip. 1840 m²**, ndodhet në lagjen “****”, Bashkia Fier, me certifikatë pronësie nr. ***, nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***. Burimi i krijimit të pasurisë: përfituar me ligjin nr. 7501/1991, “Për tokën”.
- b) **Tokë me sip. 880 m²**, ndodhet në lagjen “****”, Bashkia Fier, me certifikatë pronësie nr. ***, nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. *** (*subjekti rivlerësimit i ka deklaruar këto dy pasuri në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të deklaratës Vetting*).

Burimi i krijimit: përfituar me ligjin nr. 7501/1991, “Për tokën”.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

4.1. Këto dy pasuri janë deklaruar në deklaratën *Vetting*, si dhe në DIPP-të e viteve 2015, 2016, 2017 dhe 2018. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, këto dokumente: (1) certifikatën dhe kartelën e pasurisë së datës 7.5.2015¹², në emër të shtetasit Z.S., babai i subjektit si përfaqësues i familjes bujqësore; (2) aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP), datë 29.8.1995¹³, lëshuar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, sipas të cilit shtetasit Z.S. i është dhënë në pronësi tokë bujqësore me sipërfaqe totale 3040 m², përfshirë edhe parcelën me sip. 1840 m² dhe sip. 880 m²; (3) certifikatat familjare, datë 17.12.2014 për gjendjen familjare në datat 1.8.1991 dhe 1.10.1992, ku rezulton se në përbërje të familjes janë subjekti, prindërit dhe vëllai i subjektit.

Me shkresën datë 18.9.2017¹⁴, të ZVRPP-së Fier, konfirmohet pronësia e kësaj pasurie në emër të shtetasit Z.S., si përfaqësues i familjes bujqësore.

4.2. Komisioni vëren se në DIPP-në e vitit 2015 pasuritë janë shënuar në deklaratën e “personave të lidhur”, por nuk është nënshkruar kjo pjesë as nga subjekti dhe as nga personat e lidhur me subjektin (babai Z.S., nëna S.S. dhe vëllai D.S.). Në këtë pjesë subjekti ka deklaruar se: *“Këto prona janë të përfituara dhe të regjistruara në emër të prindërve të mi Z. dhe S.S. Këto pasuri janë të pandara dhe nuk mund të shprehem për pjesën konkrete që më takon”*.

Në DIPP-në e vitit 2016 këto prona janë deklaruar nga subjekti dhe nga personat e lidhur me të. Në të gjitha deklaratat nuk janë përcaktuar pjesët takuese mbi pasuritë.

Në lidhje me mos nënshkrimin e DIPP-së së vitit 2015 të “personave të lidhur” në rubrikën “ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit”, si dhe me mosdeklarimin e pjesëve takuese mbi pasuritë, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në pyetësin nr. 2.

4.3. Subjekti ka shpjeguar se prindërit kanë përfituar nga ligji nr. 7501/1991 tokë bujqësore me AMTP-në nr. ***, në emër të shtetasit Z.S. dhe AMTP-në nr. *** në emër të shtetasës S.S.,

¹² Certifikatë pronësisë nr. ***, datë 7.5.2015.

¹³ AMTP-ja nr. ***, datë 29.8.1995.

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2017, nga ZVRPP-ja Fier.

por duke pasur parasysh natyrën dhe karakteristikat e familjes bujqësore, si dhe faktin që në kohën kur janë ndarë tokat ka qenë i mitur dhe nuk ka marrë pjesë në procedurë, ka hezitur të përshkruajë titullarin e këtyre pasurive. Në DIPP-në e vitit 2015 nuk e ka përcaktuar një fakt të tillë, pasi këto prona janë përfituar nga prindërit për efekt të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën” dhe babai Z.S. për tokat që ka marrë me AMTP është pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie për dy pasuri të llojit “arë”, përkatësisht me sipërfaqe 1840 m² dhe 880 m², kurse nëna S.S. nga sipërfaqja totale prej 4980 m², që ka përfutur me AMTP referuar certifikatës familjare për gjendjen familjare, datë 1.10.1992, përfiton ¼ pjesë të kësaj pasurie, pra 1245 m², po atë pjesë edhe për bashkëpronarët e tjerë të këtyre pasurive. Kjo sipërfaqe toke është ende e paregjistruar në ASHK-në Fier, për arsye të mospërfundimit të procesit të regjistrimit fillestar.

4.4. Nga shpjegimet dhe provat që ka dërguar subjekti, provohet se deklarues për këto pasuri është subjekti dhe personat e lidhur me të, të cilat i përkasin në bashkëpronësi me familjen e tij si anëtarë të familjes bujqësore, pavarësisht se tokat bujqësore janë marrë dhe regjistruar në emër të prindërve të tij si kryefamiljarë. Megjithatë subjekti nuk ka dhënë shpjegime lidhur me pjesët takuese në këto pasuri.

4.5. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP pjesën takuese mbi pronësinë e tokës bujqësore, subjekti ka dhënë këto prapësime: certifikata familjare për gjendjen familjare, datë 1.10.1992, ka shërbyer si dokument ligjor bazë për shpërndarjen dhe dhënie të këtyre pronave në bazë të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”. Pra, nga sipërfaqja totale 3040 m² e tokës që është përfutur me AMTP-së nr. ***, referuar certifikatës familjare për gjendjen familjare, datë 1.10.1992, rezulton se shtetasi Z.S. përfiton ¼ pjesë të kësaj pasurie, pra, afro 760 m² dhe po kaq u takon edhe bashkëpronarëve të tjerë të këtyre pasurive që janë në përbërje familjare (S., S. dhe D.S.). Këto prona janë të regjistruara sipas certifikatave përkatëse të pronësisë të lëshuara nga ish-ZVRPP-së Fier (aktualisht ASHK-ja Fier).

Ndërkohë që nëna e subjektit S.S., nga sipërfaqja totale prej 4980 m² që ka përfutur me AMTP-në nr. ***, referuar certifikatës familjare për gjendjen familjare, datë 1.10.1992, përfiton ¼ pjesë të kësaj pasurie, pra, 1245 m² dhe po atë pjesë edhe bashkëpronarët e tjerë të këtyre pasurive (Z., S. dhe D.S.). ASHK-ja Fier konfirmon mosregjistrimin e tyre për shkak të mospërfundimit të procesit të regjistrimit fillestar në Njësinë Administrative L., Bashkia Fier dhe janë akoma në proces përditësimi.

Vlerësimi i Komisionit për çështjen

4.6. Nga shpjegimet dhe provat që ka dërguar subjekti, provohet se këto pasuri i përkasin në bashkëpronësi atij dhe familjarëve të tij si anëtarë të familjes bujqësore, pavarësisht se tokat bujqësore janë regjistruar në emër të prindërve të tij si kryefamiljarë. Sipas certifikatës familjare që pasqyron gjendjen familjare në datën 1.8.1991 (bashkëlidhur deklaratës *Vetting*) dhe certifikatës familjare, datë 1.10.1992, subjekti figuron pjesëtar në familjen e tij me 4 anëtarë dhe, për rrjedhojë, përfiton ¼ pjesë mbi çdo pasuri tokë bujqësore që ka përfutur familja e tij me AMTP sipas ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”. Shpjegimet e subjektit janë të qarta e të mjaftueshme në lidhje me përcaktimin e pjesëve takuese mbi pasuritë, por jo bindëse për të justifikuar mosdeklarimin në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP-të e tjera të pjesëve takuese të pasurive nga subjekti dhe nga personat e lidhur me të, kjo në kushtet kur i njëjti ligj dhe të

njëjtat prova ku subjekti bazon shpjegimet e tij, kanë ekzistuar edhe në kohën kur ka plotësuar deklaratën *Vetting* dhe gjithë DIPP-të më pas.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë bërë deklaram të pasaktë të pasurive, duke mos deklaruar pjesët e tyre takuese në pasurinë e paluajtshme tokë bujqësore, të përfituar në bazë të ligjit nr. 7501/1990, “Për tokën”.

5. Pasuri të llojit “arë” me sip. 3900 m² dhe me sip. 1080 m², përfituar me ligjin nr. 7501/1991

a) **Tokë bujqësore me sip. 3900 m²**, në Njësinë Administrative L., Bashkia Fier, Sh., e peregjistruar në ZRVPP, përfituar me AMTP, sipas ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”.

Burimi i krijimit: përfituar me ligjin nr. 7501/1991, “Për tokën”.

b) **Tokë ullishte me sip. 1080 m²**, në Njësinë Administrative L., Bashkia Fier, Sh., e peregjistruar në ZRVPP, përfituar me AMTP, sipas ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”.

Burimi i krijimit: përfituar me ligji nr. 7501/1991 “Për tokën” (*subjekti i ka deklaruar këto dy pasuri në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të deklaratës *Vetting**).

5.1. Këto dy pasuri janë deklaruar në deklaratën *Vetting* në rubrikën “person i lidhur” dhe në DIPP-të e viteve 2015 dhe 2016 nga personat e lidhur me subjektin (babai Z.S., nëna S.S. dhe vëllai D.S.), por subjekti ka sqaruar në DIPP-në 2015 se: *“Këto prona janë të përfituara dhe të regjistruara në emër të prindërve të mi Z. dhe S.S. Këto pasuri janë të pandara dhe nuk mund të shprehem për pjesën konkrete që më takon”*.

5.2. Hetimi dhe konstatimi i mëtejshëm i Komisionit për këto pasuri është i njëjtë, si për pasuritë në pikën 4 më lart dhe në vijim, ku pas hetimit, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë bërë deklaram të pasaktë, duke mos deklaruar pjesët e tyre takuese në pasurinë e paluajtshme tokë bujqësore, të përfituar në bazë të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”.

Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë

6. Kontratë kredie bankare datë 15.7.2016, me “Raiffeisen Bank”, në vlerën 239,700 lekë. Shuma e detyrimit financiar të mbetur pa shlyer deri në datën e fillimit të rivlerësimit është 199,307 lekë.

6.1. Komisioni ka administruar dokumentacionin bankar të vënë në dispozicion nga subjekti dhe nga “Raiffeisen Bank”¹⁵, sipas të cilit konfirmohet marrja e kredisë bankare në shumën 239,700 lekë dhe disburimi i saj në datën 19.7.2016. Kjo kredi ka shërbyer për mbylljen e kredisë së mëparshme marrë në “Raiffeisen Bank” në datën 10.8.2015, në shumën 312,000 lekë, për blerje automjeti.

Komisioni konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e depozituar nga banka dhe se subjekti ka bërë deklaram të saktë.

¹⁵ Me shkresën nr. *** prot, datë 29.1.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

7. Kartë krediti në lekë në shumën 237,000, hapur në datën 28.10.2015. Shuma e detyrimit financiar i mbetur pa shlyer deri në datën e fillimit të rivlerësimit është 237,000 lekë.

7.1. “Raiffeisen Bank”, me vërtetimin e datës 26.1.2017, konfirmon të dhënat e deklaruara nga subjekti. Kjo kartë krediti është deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2015.

Komisioni konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e depozituar nga banka dhe se subjekti ka bërë deklaram të saktë.

8. Overdraft në llogarinë rrjedhëse në lekë në shumën 40,000 lekë, hapur në datën 4.7.2014. Shuma e detyrimit financiar i mbetur pa shlyer deri në datën e fillimit të rivlerësimit është 40,000 lekë.

8.1. Ky overdraft është deklaruar nga subjekti në deklaratat vjetore të pasurisë dhe gjendja e tij konfirmohet me vërtetimin e datës 26.1.2017 dhe shkresën e “Raiffeisen Bank”¹⁶.

Komisioni konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e depozituar nga banka dhe se subjekti ka bërë deklaram të saktë.

KONSTATIME TË TJERA PËR SUBJEKTIN

9. Kredi ndaj “Credins Bank”, në cilësinë e dorëzansisë, në vlerën 180,000 lekë

9.1. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2013, deklaroi: “*Kredi ndaj ‘Credins Bank’ në cilësinë e dorëzansisë, vlera 180,000 lekë*”.

9.2. Gjatë hetimit subjekti ka depozituar në Komision kontratën e kredisë afatmesme, datë 29.10.2013¹⁷, lidhur midis “Credins Bank” si kredihënëse dhe shtetases S.S., si kredimarrëse, për shumën 180,000 lekë për një afat 2-vjeçar, me qëllim shlyerje detyrimi dhe dorëzans Saimir Smaka. Rezulton se kredia në vlerën 180,000 lekë është mbyllur në datën 18.8.2015.

9.3. Gjatë hetimit Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit se përse nuk e ka deklaruar mbylljen e saj. Subjekti ka shpjeguar se nuk e ka deklaruar mbylljen e saj, pasi titullar i kësaj kredie ka qenë nëna dhe kredia është marrë për arsye personale nga personi i lidhur nëna e tij, e cila e ka shlyer tërësisht kredinë nga kursimet e saj.

Komisioni arrin në përfundimin se shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe të bazuara në prova shkresore dhe nuk konstatoi ndonjë problematikë në lidhje me këtë kredi.

10. Kontratë kredie bankare nga “Raiffeisen Bank”, në vlerën 230,000 lekë, në gjendje të paaktivizuar

10.1. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 kartën e kreditit me limit përdorimi në vlerën 230,000 lekë, por i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* marrëveshjen mbi përdorimin e kartës individuale të kreditit *Master Card* të lidhur në datën 2.7.2016, në vlerën 230,000 lekë.

10.2. “Raiffeisen Bank” konfirmon se karta e kreditit me limit 230,000 lekë nuk është përdorur nga subjekti i rivlerësimit.

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

¹⁷ Kontratë kredie nr. ***, datë 9.10.2013.

10.3. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar disponimin e kartës së kreditit në “Raiffeisen Bank” në shumën 230,000 lekë. Për këtë, Komisioni i ngarkoi subjektin barrën e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

10.4. Subjekti ka shpjeguar se marrëveshja e kartës së kreditit me vlerë 230,000 lekë është lidhur në datën 2.7.2016, me “Raiffeisen Bank”, por për arsye personale subjekti nuk e ka përdorur. Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti ka depozituar marrëveshjen e kartës së kreditit të lidhur me “Raiffeisen Bank” në datën 2.7.2016, me vlerë 230,000 lekë.

Vlerësimi i Komisionit

10.5. Komisioni vlerëson se shpjegimi i subjektit është i saktë në lidhje me të dhënat e marrëveshjes së kartës së kreditit, por jo bindës në lidhje me arsyet e mosdeklarimit të disponimit të kësaj marrëveshje kartë krediti, në DIPP-në e vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting*. Megjithatë, fakti që subjekti e ka depozituar marrëveshjen e kartës së kreditit në dosjen *Vetting*, krijon bindjen se nuk është përpjekur ta fshehtë këtë marrëveshje për kartë krediti dhe për më tepër që nuk e ka aktivizuar atë.

Komisioni, duke marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, faktin e depozitimit të marrëveshjes së kartës së kreditit bashkë me dokumentacionin që shoqërojnë deklaratën *Vetting*, si dhe mospërdorimin e kartës së kreditit, arrin në përfundimin se kemi të bëjmë me një deklaram të pasaktë të subjektit.

Shpenzime të deklarueshme

11. Qira vjetore në bazë të kontratës së qirasë në vlerën 15,000 lekë/muaj, e shlyer tërësisht për 12 muaj. Vlera: 180,000 lekë

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

11.1. Ky shpenzim është deklaruar nga subjekti në DIPP-të për vitet 2016, 2017 dhe 2018. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratave: (1) kontratë qiraje¹⁸ për marrjen me qira nga pronari V.B. një apartament në Vlorë për një afat 1-vjeçar deri në datën 27.1.2018, me vlerë qiraje 15,000 lekë/muaj; (2) certifikatë pronësie të apartamentit në emër të z. V.B.; (3) deklaratën noteriale¹⁹ sipas së cilës z. V.B. i ka dhënë subjektit Saimir Smaka apartamentin me nr. pasurie ***, me qira për periudhën janar 2014 – janar 2017.

11.2. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se në periudhën janar 2014 – shtator 2018 ka banuar me qira 15,000 lekë/muaj në banesën e shtetasit V.B., ndërkohë prej tetorit të vitit 2018 dhe në vijim banon me qira në banesën në pronësi të shtetasit G.H. kundrejt vlerës 15,000 lekë, të ndodhur në lagjen “****”, rruga “****”, Vlorë. Bashkëlidhur, subjekti ka dërguar pranë Komisionit edhe: (1) kontratë qiraje²⁰ e lidhur me qiradhënësin G.H. për marrjen

¹⁸ Kontratë qiraje nr. ***, datë 27.1.2017.

¹⁹ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 27.1.2017.

²⁰ Kontratë qiraje nr. ***, datë 10.12.2019.

me qira të një apartamenti për një periudhë 1-vjeçare me vlerë 15,000 lekë/muaj; (2) deklaratë noteriale²¹; (3) certifikatë pronësie apartamenti, datë 8.10.2014, në emër të shtetasit G.H.

11.3. Komisioni vëren se subjekti, për periudhën janar 2014 – janar 2017, nuk ka paraqitur kontratë qiraje dhe as dokumentacion që provon pagesat e qirave.

11.4. Në lidhje me këtë konstatim subjekti ka shpjeguar se për periudhën janar 2014 – shtator 2018 ka banuar me qira prej 15,000 lekë/muaj në banesën në pronësi të shtetasit V.B., të ndodhur në lagjen “***”, rruga “***”, Vlorë dhe se pagesa e qirasë është kryer dorazi çdo muaj në vlerën 15,000 lekë.

11.5. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se gjatë kësaj kohe, për periudhën nëntor 2013 – korrik 2015, pra, për rreth 20 muaj nuk ka qëndruar në Vlorë, pavarësisht se kishte marrë banesë me qira, por e bënte vajtje-ardhje me mjete transporti udhëtarësh, ku bileta e udhëtimit ka qenë 200 lekë.

11.6. Komisioni vëren se në procesverbalin e datës 20.11.2015 të mbajtur nga ILDKPKI-ja, subjekti ka deklaruar se: “... aktualisht banoj me qira të ulët, në apartamentin e z. V.B. në lagjen ‘***’, rreth 10,000 lekë/muaj, pa kontratë dhe vetëm me marrëveshje verbale”, deklarim ky që nuk përputhet me përgjigjet ndaj pyetësorëve nr. 1 dhe nr. 2, me deklaratën noteriale, datë 27.1.2017, dhe kontratën e qirasë, datë 27.2.2017, ku subjekti ka deklaruar se për periudhën janar 2014 – shtator 2018 ka banuar në apartamentin në pronësi të shtetasit V.B. me qira 15,000 lekë/muaj.

11.7. Subjekti ka dhënë shpjegime se në periudhën janar 2014 – gusht 2015 ka paguar qira 10,000 lekë/muaj për arsye të banimit në një garsonierë në pronësi të shtetasit V.B., kurse në periudhën shtator 2015 – shtator 2018 ka qëndruar në apartament tjetër në pronësi të V.B. me sip. 63.8 m², prandaj rritja e sipërfaqes së apartamentit diktoi edhe qiranë 15,000 lekë/muaj, e cila është shlyer dorazi dhe që është pranuar me vullnet të lirë nga qiradhënësi z. V.B.

11.8. Komisioni hetoi edhe mbi ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me qiradhënësit V. B. dhe G. H. dhe nga përgjigjja e kthyer me shkresën nr. ***, datë 5.5.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

11.9. Komisioni konstatoi se:

- Për periudhën e qirasë janar 2017 – shtator 2018, subjekti nuk provon me dokumentacion pagesat mujore të qirasë, por pretendon se i ka shlyer dorazi.
- Për periudhën e qirasë janar 2014 – janar 2017, subjekti ka pasur një marrëdhënie qiraje verbale dhe jo në formën e kërkuar nga neni 803 i Kodit Civil.
- Subjekti i rivlerësimit bën deklarime kontradiktore për vlerën e qirasë mujore të periudhës nëntor 2013 – gusht 2015, sepse në procesverbalin e ILDKPKI-së datë 20.11.2015, dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 4, deklaroi vlerën 10,000 lekë/muaj, ndërsa në deklaratën noteriale datë 27.1.2017, në kontratën e qirasë datë 27.2.2017 dhe në përgjigje të pyetësorëve nr. 1 e nr. 2, deklaroi vlerën 15,000 lekë/muaj.

²¹ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 10.12.2019.

Në lidhje me këto konstatime, Komisioni i ngarkoi subjektin barrën e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

11.10. Subjekti ka shpjeguar se për periudhën janar 2014 – gusht 2015 ka paguar qira në vlerën 10,000 lekë/muaj, ndërsa për periudhën shtator 2015 – tetor 2018 ka paguar qira në vlerën 15,000 lekë/muaj. Ky ndryshim në rritjen e pagesës së qirasë diktohet nga rritja e sipërfaqes së banimit të apartamentit nga 24.3 m² në 63.8 m². Këto pagesa qiraje janë shlyer dorazi nga subjekti dhe janë pranuar me vullnet të lirë nga qiradhënësi V.B. sipas kërkesave të tij, të pashoqëruara me dokumentacion bankar. Për të provuar shpjegimet e tij, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale²² të qiradhënësit V.B., i cili konfirmon deklaratimet e subjektit.

11.11. Vlerësimi i Komisionit

i) Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat e paraqitura prej tij janë të mjaftueshme për të provuar pagesat dorazi të vlerave të qirasë, për sa kohë që qiradhënësit nuk kanë ngritur asnjëherë pretendimin se subjekti nuk i ka paguar qiratë mujore dhe nuk u gjetën në konflikt interesi me subjektin e rivlerësimit.

ii) Subjekti i rivlerësimit, për periudhën e qirasë së vazhdueshme mbi 1-vjeçare, janar 2014 – janar 2017, ka pasur një marrëdhënie qiraje verbale dhe jo në formën e kërkuar ligji, konkretisht nga neni 803 i Kodit Civil “me shkresë”.

iii) Subjekti ka dhënë shpjegime dhe të dhëna kontradiktore në lidhje me vlerat e qirasë mujore, 10,000 lekë/muaj dhe 15,000 lekë/muaj dhe kohën kur është aplikuar secila prej tyre. Komisioni vlerëson se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë të marrëdhënies së qirasë dhe vlerave të qirave mujore.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në lidhje me marrëdhënien e qirasë dhe me vlerat e qirave mujore.

PERSONI I LIDHUR/BABAI I SUBJEKTIT Z.S.

Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit

12. Pasuritë e deklaruara nga babai i subjektit Z.S.:

a) **Banesë private me sipërfaqe banimi 70 m²**, në proces legalizimi në Zyrën e ALUIZNI-t Fier.

Burimi i krijimit: nuk është deklaruar burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj pasurie.

b) **Truall me sip. 100 m²**, në proces legalizimi në zyrën e ALUIZNI-t Fier në pritje të legalizimit me qëllim kryerjen e veprimeve të tjera për regjistrimin e pronësisë.

Burimi i krijimit: subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi të kësaj pasurie.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

²² Deklaratë noteriale nr. ***, datë 1.7.2021.

12.1. Banesa dhe trualli janë deklaruar nga personi i lidhur me subjektin në DIPP-në e vitit 2016, por nuk ka përcaktuar pjesën takuese.

12.2. Nga korrespondenca me ASHK-në qendrore²³ konfirmohet se z. Z.S. ka aplikuar për legalizimin e një ndërtimi pa leje në vitin 1994, banesë 1-katëshe me sip. 74.5 m² mbi truallin me sip. 240.6 m², sipas deklaratës datë 12.12.2014, Fier dhe është pajisur me leje legalizimi nr. ***, datë 26.1.2018.

12.3. Në lidhje me mosdeklarimin e burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, pjesën takuese të babait të tij në këtë pasuri, vlerën monetare të shpenzuar për ndërtimin e këtij objekti, si dhe vlerën dhe periudhën e kryerjes së mobilimit të këtij objekti, subjekti, bashkëlidhur shpjegimeve, ka depozituar pranë Komisionit praktikën e plotë të legalizimit të përcjellë me shkresën datë 4.5.2021²⁴, të ASHK-së Fier, nga ku rezulton se shtetasi Z.S., në përfundim të procesit të legalizimit, është pajisur me certifikatën për vërtetim pronësie datë 17.9.2020²⁵, sipas së cilës në pronësi të shtetasve Z.S. dhe S.S. është regjistruar pasuria nr. ***, me sipërfaqe trualli 185.6 m², ku përfshihet sipërfaqe ndërtimore 74.5 m² e cila ndodhet në z. k. ***, lagjja “***”, Fier.

12.4. Në lidhje me pjesën takuese të babait në këtë pasuri, subjekti ka shpjeguar se nga certifikata e pronësisë provohet se babai është bashkëpronar me nënën e tij S.S., me pjesë takuese ½. Subjekti ka shpjeguar në vijim se ndërtimi ka filluar në vitin 1994 dhe ka përfunduar rreth muajit dhjetor të vitit 1995. Ky ndërtim është një shtesë e objektit të mëparshëm ekzistues në vitin 1992, ku prindërit e tij kanë pasur një banesë e cila përbëhej nga një dhomë, një banjë, një korridor dhe një ballkon (pjesa ballore e ndërtesës). Sipas planimetrisë që ndodhet edhe në praktikën e procedurës së legalizimit depozituar pranë Komisionit, rezulton se kjo banesë ka qenë afërsisht me sip. 33.165 m². ASHK-ja Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 18.5.2021 bashkëlidhur, konfirmon se nuk ekziston dokument për vërtetimin e origjinës për këtë objekt ekzistues.

12.5. Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e këtij objekti, subjekti ka shpjeguar se nga konsultimi me prindërit kjo ndërtesë që shërbente për banim është ndërtuar nga gjyshi i tij H. S. në vitin 1981 dhe sipërfaqja shtesë, referuar çmimeve bazë të artikujve apo materialeve të ndërtimit të kohës në vitet 1994 - 1995 në lidhje me vlerën e shpenzimeve që janë kryer, kap vlerën rreth 100,000 lekë. Një pjesë të këtyre shpenzimeve janë kryer nga atë ardhurat dhe kursimet e kohës së prindërve të tij dhe në kryerjen punimeve i ka ndihmuar xhaxhai i tij, shtetasi A.H.S., si forcë pune dhe me një pagesë ustai me normë për ditë pune më të ulët se tregu i punës së kohës. Shtetasi A.H.S. është teknik ndërtimi me kategori të shtatë.

12.6. Shpenzimet me qëllim mobilimi banese përkrijnë me fundvitin 2013 (momenti i fillimit të detyrës si prokuror) dhe në vazhdim. Subjekti ka shpjeguar se deri në momentin kur është dorëzuar deklarata *Vetting* të gjithë anëtarët e trungut familjar, shtetasit Z.S. (merrte kemp), S.S. (në marrëdhënie pune pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale Fier), Saimir Smaka (prokuror në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë) dhe D.S. (inxhinier, specialist, shef zyre në OST) kanë

²³ Shkresë nr. *** prot., datë 7.2.2020, ASHK-ja qendrore.

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 4.5.2021, ASHK-ja Fier.

²⁵ Certifikatë pronësie nr. ***, datë 17.9.2020.

pasur marrëdhënie financiare (pune) të rregullta dhe në lidhje me mobilimin e banesës, bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti ka depozituar të gjitha faturat e blerjes, kontratat e kredisë për shumat që ka marrë për blerje, etj., si prova me të cilat ka provuar shpjegimet e tij.

12.7. Për sa më lart, Komisioni vlerëson se për pjesën takuese të babait të tij në pasurinë nr. ***, të ndodhur në lagjen “***”, Fier dhe për procesin e fitimit të pronësisë mbi këtë pasuri, shpjegimet dhe provat që ka paraqitur subjekti janë të mjaftueshme dhe bindëse.

Komisioni vlerëson se deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të objektit shtesë, duke pasur parasysh se ky objekt është ndërtuar shumë kohë përpara se subjekti të fillonte detyrën si prokuror, për të provuar shpenzimet e krijimit të kësaj pasurie, si dhe vlerën dhe periudhën e kryerjes së mobilimit të këtij objekti, janë të mjaftueshme dhe bindëse. Vlera totale e shpenzimeve të mobilimit të godinës është deklaruar rreth 687,150 lekë. Këto shpenzime nuk janë përfshirë në analizë financiare sepse, siç rezultojnë nga provat, janë kryer pas vitit 2016, me përjashtim të blerjes së një minibari në vlerën 60,000 lekë nga subjekti në korrik të vitit 2016.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me situatën ligjore të kësaj pasurie, origjinën dhe kohën e ndërtimit të saj, shpenzimet e ndërtimit dhe të mobilimit, duke mos u konstatuar ndonjë problematikë që mund të ngarkojë me përgjegjësi disiplinore subjektin në lidhje me kriterin e pasurisë.

PERSONI I LIDHUR/ NËNA E SUBJEKTIT S.S.

Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit

13. Llogari rrjedhëse me nr. *, paga aktuale në datën e deklaratimit. Vlera: 559.94 lekë. Pjesa takuese: 100 %**

Burimi i krijimit: nga pagat.

13.1. “Raiffeisen Bank” konfirmon llogarinë bankare në emër të personit të lidhur në të cilën janë kredituar të ardhurat nga paga duke filluar nga viti 2016 e në vijim.

Komisioni arrin në përfundimin se shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe të bazuara në prova shkresore dhe nuk konstatoi ndonjë problematikë në lidhje me këtë deklaratim.

14. Nga dokumentacioni i administruar rezultojnë se personi i lidhur/nëna e subjektit S.S. dhe 5 bashkëpronarë në datën 3.10.2013 kanë shitur apartamentin me sip. 53.3 m² për çmimin 1,460,000 lekë. Sipas certifikatës për vërtetim pronësie datë 24.9.2013, lëshuar nga ish-ZVRPP-ja Fier rezultojnë se shtetasja S.S. është bashkëpronare me 1/20 pjesë.

14.1. Komisioni i ka kërkuar subjektit që: (i) të japë shpjegime dhe të provojë nëse nëna e tij ka përfutur të ardhura nga shitja e apartamentit dhe të specifikojë shumën e përfutur dhe përdorimin e saj; si dhe (ii) të japë shpjegime për mosdeklarimin e këtyre të ardhurave në asnjë deklaratë pasurie.

14.2. Subjekti ka shpjeguar se nëna e tij S.S. ishte bashkëpronare me 1/20 pjesë të pasurisë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, ndodhur në L., Fier. Kjo pronë është shitur nga shtetasi A.R.

dhe Gj.R., si bashkëpronare, me kontratë shitblerjeje datë 3.10.2013²⁶, në shumën 1,460,000 lekë, veprim të cilin e ka kryer në bazë të prokurës së posaçme²⁷, ku ajo ka dhënë pëlqimin për kryerjen e këtij veprimi juridik pa kundërshpërblim ndaj saj. Arsyeja e mosdeklarimit në DIPP-të e viteve 2014, 2015, 2016 dhe 2017 është fakti se shtetasja S.S. nuk ka përfituar kundërshpërblim monetar në të ardhura nga ky veprim juridik, kjo për faktin se pjesa e saj takuese në këtë pasuri është relativisht e vogël 1/20 pjesë (rreth 73,000 lekë referuar çmimit të shitjes) dhe se nuk banonte aty prej vitesh, që prej martesës në shtator të vitit 1985. Në këtë banesë banonte shtetasi A.R. dhe nëna e shtetasës S.S.

14.3. Komisioni vëren se kjo pasuri është shitur nga personi i lidhur/nëna e subjektit S.S. dhe bashkëpronarët, përpara se subjekti të kishte filluar punën dhe të ishte subjekt deklarues, për rrjedhojë, ajo nuk kishte detyrim të deklaronte pjesën e saj takuese mbi këtë pasuri në deklaratën e pasurisë për herë të parë të vitit 2013. Gjithashtu, Komisioni i vlerëson të mjaftueshme dhe bindëse arsyet e mosdeklarimit të pjesës takuese mbi të ardhurat e përfituara nga nëna e tij nga shitja e apartamentit, për sa kohë që ajo nuk e ka disponuar ndonjëherë këtë shumë.

Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë në lidhje me këtë pasuri.

PERSONI I LIDHUR/ VËLLAI I SUBJEKTIT D.S.

I. Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit

15. Llogari rrjedhëse me nr. *, paga aktuale në momentin e deklarimit të subjektit. Vlera: 4,493.6 lekë. Pjesa takuese: 100 %**

15.1. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* një përshkrim datë 27.1.2017, të llogarisë nr. ***, nga BKT-ja. Në këtë llogari rezultojnë transaksione bankare nga data 10.10.2012, konkretisht disbursimi i një kredie bankare në shumën 250,000 lekë dhe nga viti 2014 janë kredituar të ardhurat nga punësimi i vëllait të subjektit në OST.

Kjo llogari është deklaruar nga personi i lidhur/vëllai i subjektit D.S. edhe në DIPP-në e vitit 2016.

Komisioni arrin në përfundimin se deklarimi i personit të lidhur/ vëllai i subjektit D.S. përputhet me dokumentacionin përkatës dhe nuk u konstatua ndonjë problematikë në lidhje me këtë deklaram.

16. Automjet tip “Volkswagen Golf 4”, vit prodhimi 1998, me targa *. Vlera: 2,000 euro. Pjesa takuese: 100 %**

Burimi i krijimit: nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie.

16.1. Nga korrespondenca e kryer në datën 3.2.2020²⁸ me DPSHTRR-në, e cila ka dërguar pranë Komisionit dosjen e këtij automjeti, rezulton se me kontratën e shitjes datë 27.9.2016²⁹, shtetasi D.S. ka blerë nga shitësit A. dhe A.Sh. këtë automjet për çmimin 2,000 euro.

²⁶ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 3.10.2013.

²⁷ Prokurë e posaçme nr. ***.

²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 3.2.2020, e DPSHTRR-së.

²⁹ Kontratë shitjeje nr. ***, datë 27.9.2016.

16.2. Komisioni vëren se personi i lidhur nuk ka deklaruar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie. Për këtë, në pyetësonin nr. 4, Komisioni i ka kërkuar subjektit të identifikojë burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, duke vënë në dispozicion edhe dokumentacionin që justifikon burimin e ligjshëm të kësaj pasurie.

16.3. Subjekti ka shpjeguar se shumën 2,000 euro *cash* personi i lidhur D.S. e ka siguruar nga kursimet nga rroga si inxhinier elektrik në OST sh.a., duke bashkëlidhur si provë vërtetimin datë 30.4.2021³⁰, të OSHEE-së për pagat *neto* dhe *bruto* për periudhën 1.7.2014 – 30.3.2021.

16.4. Komisioni kreu analizën financiare mbi mundësinë e personit të lidhur/vëllait të subjektit për blerjen e automjetit me targa ***, në datën 27.9.2016, me të ardhura nga pagat, në të cilën rezulton me balancë pozitive, çka do të thotë se ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit në vlerën 2,000 euro.

Përshkrimi	1.1.2016 - 27.9.2016
<i>Të ardhurat nga pagat në bankë</i>	583 725
<i>Detyrime - Kredi</i>	300 000
<i>Shpenzime</i>	569 945
Shpenzime jetike	176 319
Shpenzime kredie	93 626
Shpenzime riparim shtëpie	300 000
<i>Pasuri</i>	246 307
Ndryshim likuiditeti	-24 233
Blerje automjeti, datë 27.9.2016 (2,000 euro)	270 540
Mundësia financiare (të ardhura+ kredi pasuri-shpenzime)	67 473

Komisioni arrin në përfundimin se personi i lidhur/ vëllai i subjektit D.S. ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme financiare për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Golf 4” në datën 27.9.2016, për çmimin 2,000 euro.

II. Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë

17. Kontratë kredie bankare në shumën 300,000 lekë, e hapur në datën 23.8.2016 me BKT-në, me afat 24 muaj. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur pa shlyer deri në datën e fillimit të punës është 239,988 lekë.

17.1. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* kontratën e kredisë datë 22.8.2016, të lidhur me BKT-në, si dhe vërtetimin datë 27.1.2017, nga kjo bankë, akte të cilat provojnë deklarinimin e subjektit.

17.2. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka depozituar kontratën e kredisë bankare në BKT, si më lart (qëllimi: për rregullime banese) dhe përshkrimin e llogarisë bankare ku konfirmohet marrja e kredisë në shumën 300,000 lekë.

³⁰ Vërtetim nr. ***, datë 30.4.2021, e OSHEE-së.

17.3. Komisioni arrin në përfundimin se nuk ka problematikë lidhur me kredinë e marrë nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit në shumën 300,000 lekë.

Komisioni arrin në përfundimin se deklarimi i personi të lidhur, vëllai i subjektit të rivlerësimit, përputhet me dokumentacionin bankar, duke e konsideruar deklarimin të saktë.

III. Konstatime të tjera për personin e lidhur/vëllai i subjektit D.S.

18. Banesë në Sh., Durrës

18.1. Kjo pasuri është konstatuar nga Komisioni gjatë shqyrtimit të shkresës datë 4.2.2020³¹, që Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) ka dërguar pranë Komisionit, nga ku ka rezultuar se personi i lidhur/vëllai i subjektin D.S. ka lidhur kontratë me nr. ***, datë 4.4.2018, me FSHU-në, për apartamentin ***, kati i ***, të ndodhur në rrugën “***”, Durrës. Kontrata është lidhur në datën 4.4.2018.

18.2. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit që të provojë me dokumentacion titullin ligjor me të cilin vëllai i tij D.S. e disponon këtë apartament, periudhën e disponimit, burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie dhe nëse ka titullin e pronarit mbi të.

18.3. Subjekti ka dhënë shpjegime se personi i lidhur D.S., së bashku me bashkëshorten B.G., janë bashkëpronarë secili me 1/2 pjesë mbi pasurinë nr. ***, apartament nr. ***, me sipërfaqe totale 79.2 m² dhe titulli ligjor i disponimit të kësaj prone është certifikata për vërtetim pronësie datë 2.3.2019. Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti me vlerë 50,000.00 euro, subjekti ka shpjeguar se janë kursimet ndër vite të bashkëshortes së vëllait B.G., përkatësisht në vlerën 15,000.00 euro dhe pjesa tjetër prej 35,000.00 euro është siguruar nëpërmjet një kontrate kredie në “Intesa Sanpaolo Bank”.

Subjekti i ka bashkëlidhur shpjegimeve: (i) kontratën e shitjes³² me rezervë apartamenti, datë 4.2.2019, e lidhur midis shoqërisë “***” sh.p.k. si shitëse dhe blerësve D.S. e B.G., sipas së cilës blerësit blejnë me rezervë kundrejt çmimit 50,000 euro apartamentin nr. ***, me sipërfaqe totale 79.2 m²; (ii) kontratën e sipërmarrjes datë 22.7.2016³³, e lidhur midis shoqërisë “***” sh.p.k. dhe porositësit I.D., për ndërtimin e apartamentit të lartpërmendur; (iii) deklaratën noteriale datë 2.2.2019³⁴, e nënshkruar nga shoqëria “***” sh.p.k. dhe shtetasi I.D. për revokimin e kontratës së sipërmarrjes datë 22.7.2016.

18.4. FSHU-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2021, ka dërguar pranë Komisionit praktikën e lidhjes së kontratës nr. ***, të furnizimit me energji elektrike, e cila është lidhur fillimisht midis këtij institucioni dhe shtetasit I.D. dhe në datën 7.3.2019 midis FSHU-së dhe shtetasit D.S.

18.5. Komisioni, për të shmangur çdo dyshim në lidhje me pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, kreu hetime të thelluara mbi këtë pasuri, pavarësisht se kemi të bëjmë me një

³¹ Shkresë nr. *** prot., datë 4.2.2020, e FSHU-së.

³² Kontratë shitjeje me rezervë nr. ***, datë 4.2.2019.

³³ Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 22.7.2016.

³⁴ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 2.2.2019.

pasuri të krijuar nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, pas depozitimit të deklaratës *Vetting*.

Komisioni, pasi mori në analizë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat përkatëse, arrin në përfundimin se shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe provat që ka depozituar janë të ligjshme, të mjaftueshme dhe bindëse, për të provuar se pasuria (apartament me sip. 79.2 m², nr. ***, e ndodhur në Sh., Durrës) ka burim të ligjshëm krijimi dhe është në pronësi të personit të lidhur D. S. dhe bashkëshortes B. S.

19. ANALIZA FINANCIARE

19.1. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve ne Republikën e Shqipërisë”, Komisioni përgatiti analizën financiare mbështetur në të dhënat e deklaratimeve periodike vjetore pranë ILDKPKI-së, deklaratës *Vetting*, informacioneve të ardhura nga institucionet përkatëse dhe deklaratimet e vetë subjektit Saimir Smaka, i cili ka qenë subjekt deklarimi pa ndërprerje që prej vitit 2013. Analiza shërben për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për të realizuar kursimet, pasuritë e deklaruara dhe për të paguar shpenzimet, si dhe evidentimin e rasteve kur subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara (pasuri të luajtshme, të paluajtshme, likuiditete) dhe shpenzimet e kryera. Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar 2013 – 2016, bazohet:

- Në të ardhurat e ligjshme për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Të ardhurat nga pagat dhe honoraret në vlerë neto sipas vërtetimeve lëshuar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit³⁵ dhe personat e lidhur/prindërit dhe vëllai³⁶.
- Në rubrikën e detyrimeve janë pasqyruar shumat e marra kredi, referuar kontratave të kredive bankare të marra nga subjekti i rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”³⁷, nga nëna e subjektit S.S. në “Credins Bank”³⁸, si dhe nga vëllai i subjektit D.S. në BKT³⁹.
- Lidhur me shpenzimet e deklaruara u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit. Për analizimin e shpenzimeve u morën në konsideratë: shpenzimet e jetesës llogaritur për familje me 4 anëtarë, bazuar në deklarinimin e subjektit dhe shpenzimet e përcaktuara në shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së drejtuar Komisionit; shpenzimet e qirasë sipas deklaratës noteriale⁴⁰ dhe sipas deklaratimeve të subjektit në DIPP dhe pyetësorë; shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit të llogaritura, bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht lëvizjet hyrje-dalje nëpërmjet sistemit TIMS të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve, referuar deklaratimeve të tij dhe dokumentacionit provues të vënë në dispozicion për udhëtimet e mbuluara nga institucioni; shpenzimet për këstet e

³⁵ Vërtetim nr. *** prot., datë 25.1.2017, nga Shkolla e Magjistraturës; vërtetim nr. *** prot., datë 19.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

³⁶ Vërtetim nr. *** prot., datë 10.11.2016, nga ISSH-ja Fier për z. Z.S., periudha 13.10.2011 – 31.10.2015; vërtetim punëdhënësi: Bashkia Fier/Qendra Ekonomike e Arsimit/Kopshti “****”, Fier, për znj. S.S., periudha 1998 – 2016; vërtetim nr. *** prot., datë 24.1.2017, nga OST-ja për z. D.S., periudha 1.7.2014 – 31.12.2016.

³⁷ Kontratë kredie bankare datë 10.8.2015, në shumën 312,000 lekë, marrë nga subjekti i rivlerësimit për blerje automjeti; kontratë kredie bankare datë 11.1.2016, në shumën 53,000 lekë, marrë nga subjekti i rivlerësimit për blerje TV; kontratë kredie bankare datë 15.7.2016, në shumën 239,700 lekë, marrë nga subjekti i rivlerësimit për mbyllje të kredisë së mëparshme.

³⁸ Kontratë kredie bankare datë 25.10.2013, në shumën 180,000 lekë, marrë në “Credins Bank” nga znj. S.S.

³⁹ Kontratë kredie bankare datë 23.8.2016, në shumën 300,000 lekë, marrë nga z. D.S. në BKT për rregullim banese.

⁴⁰ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 27.1.2017.

kredive sipas dokumentacionit bankar për pagesat e kësteve të kryera për periudhën 2013 – 2016; shpenzime udhëtimi pune me mjete të transportit publik, sipas deklaratimit të subjektit në pyetësin nr. 4; shpenzime për blerje TV, sipas deklaratimit të subjektit dhe dokumentacionit provues⁴¹; shpenzime për rregullim banese, sipas destinacionit të kredisë marrë nga shtetasi D.S. në shumën 300,000 lekë; shpenzime mobilimi, sipas deklaratimit në pyetësin nr. 4; kredi e shpenzuar sipas destinacionit të përcaktuar në kontratën e kredisë “përdorim personal”.

- Lidhur me *pasuritë* e krijuara dhe *kursimet* e deklaruara, u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë deklaruar në DIPP *kursime cash*, ndërsa *likuiditetet në bankë*⁴² janë marrë në konsideratë sipas pasqyrave të lëvizjeve bankare të individëve. Në analizën financiare është pasqyruar ndryshimi i zërit likuiditete, pra shtesa ose pakësimi i ndodhur gjatë vitit përkatës në likuiditete (bankë + *cash*). *Pasuritë e luajtshme*⁴³ të krijuara gjatë periudhës së deklaratimit 2013 – 2016 sipas kontratave të shitblerjes dhe *pasuritë e paluajtshme*⁴⁴ të krijuara para kësaj periudhe sipas dokumentacionit provues.

19.2. Komisioni ka konstatuar se nga analiza e deklaratës *Vetting*, deklaratës para fillimit të detyrës së vitit 2013 dhe DIPP-ve, për periudhën e hetimit 2013 – 2016 të kryer, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe për të krijuar pasurinë, në shumën totale prej 172,731 lekësh.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimet e Komisionit

19.3. Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe Aneksit D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, subjektit iu kalua barra e provës. Në seancën dëgjimore të datës 7.7.2021 subjekti nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me konstatimin e mësipërm.

Vlerësimi i Komisionit

19.4. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë të mjaftueshme dhe bindëse për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe për të krijuar pasurinë, në shumën totale prej 172,731 lekësh.

Përshkrimi	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
Të ardhurat	924 553	2 070 192	2 300 789	2 721 197
Të ardhura nga paga e subjektit	434 270	1 069 369	901 362	1 412 130
Të ardhura nga pensioni i invaliditetit	189 831	195 617	165 512	-
Të ardhura nga paga e nënës	300 452	316 483	316 484	316 488
Të ardhura nga paga e vëllait	-	488 723	917 431	992 579

⁴¹ Fatura tatimore nr. ***, datë 27.12.2015, për blerje TV, në shumën 92,990 lekë, nga të cilat 42,990 lekë janë parapaguar dhe 50,000 lekë janë paguar me kredinë e disbursuar në janar të vitit 2016; nxjerrja e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”.

⁴² Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2020, e “Raiffeisen Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 7.2.2020, e “Intesa Sanpaolo Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 19.7.2017, e FI Bank, dërguar në ILDKPKI; shkresë nr. *** prot., datë 19.5.2021, e BKT-së.

⁴³ Kontratë nr. ***, datë 24.8.2015; kontratë nr. ***, datë 27.9.2016.

⁴⁴ AMTP-ja datë 29.8.1995 (nr. regj. ***); AMTP-ja datë 31.7.1991 (nr. regj. ***) për tokat bujqësore; leje legalizimi nr. ***, datë 26.1.2018 dhe certifikatë pronësie nr. ***, datë 17.9.2020.

Detyrime	180 000	-	312 000	592 700
Kredi RBAL_312,000 _S_10.8.2015 për blerje automjeti			312 000	
Kredi RBAL_53,000 _S_11.1.2016 për blerje TV				53 000
Kredi RBAL_239,700 _S_15.7.2016 për mbyllje kredie 312,000				239 700
<i>Kredi Credins_180,000 _Sa_25.10.2013</i>	<i>180 000</i>			
Kredi bankare BKT_300,000 _D_23.8.2016				300 000
Shpenzime	1 004 523	1 360 288	1 384 168	2 070 972
Shpenzime jetike	564 096	879 992	897 104	940 368
Shpenzime udhëtimi	-	54 643	-	40 581
Shpenzime kësti, kredi 10.8.2015			54 176	294 691
Shpenzime kësti, kredi 2016_11.1.2016				58 068
Shpenzime kësti, kredi 2016_15.7.2016				46 551
Shpenzime blerje TV			42 990	50 000
Shpenzime kësti_Credins_200,000 _Sa_25.10.2011	149 475			
Shpenzime kësti_Credins_180,000 _Sa_25.10.2013	20 487	106 789	88 633	
Kredi e shpenzuar	180 000			
Shpenzime qira	-	180 000	180 000	180 000
Shpenzime kësti_BKT_250,000 _D_15.10.2012	90 465	90 465	90 465	72 844
Shpenzime kësti_BKT_300,000 _D_25.8.2016				60 626
Shpenzime siguracion dhe taksa, automjeti me targa ***	-	-	-	27 244
Shpenzime për rregullim shtëpie me burim kredinë 300,000 në BKT	-	-	-	300 000
Shpenzime udhëtimi pune		48 400	30 800	
Pasuri	(165 866)	882 635	1 151 368	371 469
Kursime (Shtim/pakësim likuiditetesh cash + bankë)	(165 866)	882 635	523 213	100 929
Automjet “Mercedes-Benz C Class”, viti 2003, 08/2015 me targa ***			628 155	
Sip. 1840 m ² , nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***				
Sip. 880 m ² , nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***				
Sip. 3900 m ² tokë bujqësore, L., Fier në emër të prindërve				
Sip. 1080 m ² tokë ullishte, L., Fier, në emër të prindërve				
Banesë private me sip. 70 m ²				
Truall 100m ²				
Automjet tip “Volkswagen Golf 4”, vit prodhimi 1998, me targa ***				270 540
Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri	265 897	-172 731	77 253	871 6

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, për periudhën 2013 – 2016, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë në shumën 172,731 lekë, gjithashtu rezulton me balancë financiare negative në shumën 1,719,000

lekë në lidhje me depozitimet *cash* në llogari bankare në vitet 2014 – 2015 me të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e tokës bujqësore.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

20. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në lidhje me deklarimin e burimit të ligjshëm të krijimit të depozitimeve *cash* në vitet 2014 – 2015, në shumën totale prej 1,719,000 lekësh, duke deklaruar si burim fillimisht në procesverbalin e ILDKPKI-së në datë 20.11.2015, të ardhura nga dhënia e tokës bujqësore me qira dhe gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, kursimet personale nga paga.

20.1. Subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumë prej 1,719,000 lekësh, e krijuar nga depozitimet *cash* të subjektit në bankë gjatë viteve 2014 – 2015.

20.2. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë bërë deklaram të pasaktë të pasurive, duke mos deklaruar pjesët e tyre takuese në pasurinë e paluajtshme tokë bujqësore, të përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, “Për Tokën”. ndërkohë që në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar të ardhura nga dhënia me qira e tokës bujqësore, të cilat kanë shërbyer më pas për kryerjen e depozitimeve *cash* në bankë në periudhën 2014 – 2015, në vlerën totale prej 1,719,000 lekësh.

20.3. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në lidhje me mosdeklarimin e kartës së kreditit në DIPP-në e vitit 2016.

20.4. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në lidhje me marrëdhënien e qirasë dhe me vlerat e qirave mujore.

20.5. subjekti i rivlerësimit, për periudhën 2013 – 2016, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë në shumën 172,731 lekë, gjithashtu rezulton me balancë financiare negative prej 1,719,000 lekësh në lidhje me depozitimet *cash* në llogari bankare në vitet 2014 – 2015, me të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e tokës bujqësore.

20.6 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Saimir Smaka, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), me shkresën datë 30.4.2021⁴⁵ dhe shkresën datë 30.10.2017⁴⁶, ka dërguar në Komision raportin datë 30.10.2017⁴⁷, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Saimir Smaka, i deklasifikuar plotësisht me

⁴⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 30.4.2021, e DSIK-së.

⁴⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 30.10.2017, e DSIK-së.

⁴⁷ Raporti nr. ***, datë 30.10.2017, i DSIK-së.

vendimin datë 30.4.2021⁴⁸, të KDZH-së. Sipas këtij raporti, Grupi i Punës i DSIK-së, në përfundim të verifikimit ka konkluduar se:

a) *Subjekti i rivlerësimit ka pasur të njëjtat gjeneralitete si ato që ka deklaruar vetë në deklaratën për kontrollin e figurës.*

b) *Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.*

2. Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë e subjektit Saimir Z. Smaka për vazhdimin e detyrës.

3. Pavarësisht nga konkluzioni i mësipërm i DSIK-së, nisur nga informacioni i ardhur nga autoritetet verifikuese, trupi gjykues, bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, analizoi provat e administruara nga ana e autoriteteve verifikuese. Në përfundim të hetimeve, një pjesë e rezultateve të cilave pasqyrohet në raportin profesional, rezultoi se përmbajtja e këtyre materialeve përputhet dhe mbështet informacionin e ardhur nga organet ligjzbatuese. Bazuar në informacionet dhe dokumentacionet e klasifikuara, të cilat nuk mund të përdoren në aktet publike apo të vihen në dispozicion të subjektit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

Komisionit nuk i ka vënë në dispozicion subjektit të gjithë dokumentacioni i klasifikuar, me përjashtim të atij të përfshirë në një pjesë të rezultateve në lidhje me vlerësimin profesional, duke mbajtur në konsideratë edhe qëndrimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila në vendimin Regner kundër Republikës Çeke është shprehur: *“Duke pasur parasysh gjykimin në tërësi, natyrën e mosmarrëveshjes dhe marzhën e vlerësimit që gëzojnë autoritetet e brendshme, kufizimet që veprojnë mbi gëzimin e të drejtave nga kërkuesi, të dhëna atij në pajtim me parimet e gjyimit bazuar në parimet e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, ish-in balancuar në një mënyrë të tillë që një balancë e drejtë ndërmjet palëve nuk ishte cenuar në mënyrë të tillë që të cenonte thelbin e së drejtës së kërkuesit për një gjykim të drejtë. [...] E drejta për zbulimin e provave përkatëse nuk është një e drejtë absolute. Në çështjen penale ka gjetur se mund të ketë interesa konkurruese, siç është siguria kombëtare ose nevoja për të mbrojtur dëshmitarët në rrezik të hakmarrjes ose të mbajë sekret metodat e policisë për hetimin e krimit, të cilat duhet të vlerësohen kundrejt të drejtave të palës në gjykim [...]. Në rastet kur provat nuk i janë vënë në dispozicion kërkuesit për arsye të interesit publik, gjykata duhet të shqyrtojë procedurën e vendimmarrjes për të siguruar që, për aq sa është e mundur, t’u përmbahet kërkesave për të siguruar parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve dhe të ofrojë garanci të përshtatshme për të mbrojtur interesat e personit në fjalë [...]”.*

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

1. Rivlerësimi profesional sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është i bazuar në raportin e përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) si organi ndihmës për vlerësimin profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

⁴⁸ Vendim nr. ***, datë 30.4.2021, i KDZH-së.

2. KLP-ja ka hartuar dhe miratuar raportin vlerësues nr. *** prot., datë 15.5.2020, për subjektin e rivlerësimit, z. Saimir Smaka, ku për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016 janë analizuar: (a) aftësitë profesionale⁴⁹; (b) aftësitë organizative⁵⁰, (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale⁵¹; si dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional⁵². Raporti gjithashtu është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit; tri dokumenteve të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit; pesë dosjet e përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe objektiv.

C/1. Formulari i vetëdeklarimit i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit paraqitet i nënshkruar pa mangësi dhe pa kundërthënie nga subjekti, sipas shtojcës që parashikon ligji, i plotë në lidhje me deklaratimet për të dhënat statistikore, trajnimet brenda dhe jashtë Shkollës së Magjistraturës, të shoqëruara me dokumentacion provues (certifikata trajnimi, diploma, vërtetime), si dhe tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti.

C/2. Dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Dokumenti 1 – kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, në ngarkim të të pandehurve L. M., E. Xh. Dhe B. H., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “shkatërrim të pronës me zjarr”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 151/1 dhe 25 të Kodit Penal.

Dokumenti 2 – kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, në ngarkim të të pandehurit A. S. i akuzuar për veprat penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake e municioneve” dhe “drejtim të mjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga nenet 278/1 dhe 291 të Kodit Penal.

Dokumenti 3 – vendim për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për të pandehurin F. M., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Bazuar në raportin KLP-së dhe dokumentacionin e shqyrtuar nga Komisioni, nuk janë konstatuar problematika që çojnë në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit për sa i përket aspektit profesional.

C/3. Dosjet e përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe objektiv

Dosja nr. 1 – kallëzimi penal nr. *, datë 26.11.2014**

⁴⁹ Aftësitë profesionale: (a) në aspektin e *njohurive ligjore*, subjekti shfaq aftësi në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, identifikon drejtë normën ligjore të zbatueshme dhe argumenton zbatimin e saj në rastin konkret (me përjashtim të një rasti në dosjen nr. 2 të përzgjedhur nga subjekti); (b) në aspektin e *arsyetimit ligjor*, shfaq aftësi në arsyetimin ligjor e logjik, duke përpiluar vendime e akte të kuptueshme me tekst të qartë, me strukturë të akteve të qëndrueshme, të mirëorganizuar dhe të standardizuar. Subjekti ka marrë pjesë në aktivitete profesionale për ngritjen e nivelit të tij profesional.

⁵⁰ Aftësitë organizative: (a) në aspektin e *aftësisë për të përballuar ngarkesën në punë*, subjekti i ka kryer hetimet brenda një afati të arsyeshëm në raport me kompleksitetin dhe llojshmërinë e çështjeve; (b) në aspektin e *aftësisë për të kryer procedurat hetimore*, subjekti ka kryer veprimet e duhura hetimore në kohë të arsyeshme; (c) në aspektin e *aftësisë për të administruar dosjet*, dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale janë të sakta, të strukturuar, në respektim të normave të drejtshkrimit.

⁵¹ Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale: subjekti paraqet komunikim dhe bashkëpunim korrekt me kolegët, eprorët e vartësit. Nuk konstatohet që nga 5 dosjet e vëzhguara të kenë dalë të dhëna me imunitetin e tij ndaj ndonjë ndikimi apo presion të jashtëm, ndonjë shkak paanësie i dokumentuar apo cenim i të drejtave të pjesëmarrësve në proces apo të grupeve shoqërore vulnerable.

⁵² Aftësitë personale dhe angazhimi profesional: (a) aftësitë e komunikimit; (b) aftësia për të bashkëpunuar; (c) gatishmëria për t'u angazhuar. Subjekti shfaq aftësi të mira komunikimi, sjellje të mirë, ka aftësi bashkëpunimi dhe pune në grup, është angazhuar në disa aktivitete profesionale.

1.1. Në Komisarlatin e Policisë Vlorë në datën 20.10.2014 është paraqitur shtetasi R. S., i cili ka bërë kallëzim për shqetësim të vazhdueshëm nga një numër telefonik i fshehtë me *sms* dhe thirrje keqdashëse. Procedimi është regjistruar në datën 26.11.2014. Për një periudhë 8-mujore subjektit i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim dhe në datën 8.7.2015 ka nxjerrë urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore. Në këtë rast, subjekti duhej t'i dërgonte shkresë kompanive celulare për të mundësuar identifikimin e personit që ka bërë këto telefonata, veprime të cilat nuk i ka kryer. Ankuesi ka deklaruar në datën 15.7.2015 tërheqjen e ankimit. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin datë 10.7.2015, ka vendosur “mosfillimin e procedimit penal”. Vendimi i është njoftuar ankuesit në datën 1.9.2015.

1.2. Komisioni vëren se nga raporti i Grupit të Punës pranë KLGJ-së dhe pas administrimit të dokumentacionit nga Komisioni, është konstatuar se:

a) Subjekti, pa shkaqe të përligjura, ka tejkaluar afatet e marrjes së vendimeve të përcaktuara në udhëzimin nr. ***, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar me udhëzimin nr. ***, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. ***, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”.

b) Vendimi i mosfillimit është nxjerrë 5 ditë përpara se ankuesi të tërhiqte ankimin, për rrjedhojë, subjekti rezulton se nuk e ka argumentuar vendimin e mosfillimit të procedimit penal.

c) Vendimi datë 10.7.2015, “Për mosfillim të procedimit penal” i është komunikuar ankuesit në datën 1.9.2015 dhe jo menjëherë siç përcakton neni 291/2 Kodit të Procedurës Penale.

Për konstatimin e mësipërm, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin E të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.3. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, nuk ka dhënë shpjegime lidhur me konstatimet e mësipërme. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime vetëm në seancën dëgjimore datë 5.7.2021, për konstatimin e pikave (a) dhe (c). Në lidhje me konstatimin e pikës (a) subjekti ka shpjeguar se deri në vitin 2017 Kodi i Procedurës Penale nuk parashikonte afatin ligjor brenda të cilit prokurori duhej të shprehej për “mosfillim” apo për “regjistrim procedimi penal”, por ka qenë një udhëzim administrativ i Prokurorit të Përgjithshëm për një afat 30-ditor. Me ndryshimet e reja ligjore, Kodit i Procedurës Penale ka parashikuar afatin 15-ditor dhe subjekti shpjegon se ky udhëzim administrativ ka rënë nga fuqia dhe kështu që nuk mendon se në këtë rast ka kryer ndonjë shkelje ligjore.

Pyetjes së trupit gjykues nëse subjekti e ka zbatuar këtë udhëzim kur ishte në fuqi, subjekti i është përgjigjur se e ka zbatuar në shumicën e rasteve.

Në lidhje me konstatimin e pikës (c) subjekti ka shpjeguar se nuk është detyra e prokurorit që të njoftojë ankuesin, sepse prokurori e dorëzon vendimin në sekretari ashtu siç bën gjyqtari, ka ftues gjyqësor dhe sekretari gjyqësorë e cila merret me njoftimin e palëve.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

1.4. Trupi gjykues vëren se Kodit i Procedurës Penale që ka qenë në fuqi në kohën kur subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin datë 10.7.2015, për “mosfillimin e procedimit penal”, nuk përcaktonte afat ditor për marrjen e vendimit të “mosfillimit të procedimit”. Me udhëzimin nr. ***, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. *** dt.21.11.2005 “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, është parashikuar afati maksimal 30-ditor nga data e mbërritjes së kallëzimit apo referimit të veprës penale, kur prokurori duhet të marrë vendim për “mosfillimin e procedimit”. Sipas këtij udhëzimi gjatë periudhës 30-ditore prokurori kryen vetëm verifikime në lidhje me rrethanat që lejojnë ose nuk lejojnë fillimin e procedimit penal.

Deri në datën 30.3.2017, kur me ligjin nr. 35/2017 janë bërë ndryshime në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, duke përcaktuar “afatin për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit”, udhëzimi nr. *** datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. ***, datë 21.11.2005” ka qenë në fuqi, por nuk është respektuar nga subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë mangësi nuk kanë bazë ligjore.

1.5. Në lidhje me shpjegimin e subjektit rreth konstatimit të pikës c), Komisioni vëren se në interpretim të këtyre dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të kohës në fuqi, neni 134, pika 1, që përcakton se: “*Njoftimi i akteve të prokurorit, gjatë hetimeve paraprake bëhet nga policia gjyqësore ose nëpërmjet shërbimit postar...*”; neni 24 që përcakton se: “*Prokurori ushtron ndjekjen penale, bën hetime, kontrollon hetimet paraprake, ngre akuzë në gjykatë dhe merr masa për ekzekutimin e vendimeve në përputhje me rregullat e caktuara në këtë Kod*”; neni 277, pika 2 që përcakton se: “*Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore*”, kuptohet qartë se detyrën e njoftimit të akteve të prokurorit ligji ia ka ngarkuar oficerit të policisë gjyqësore dhe detyrën për të kontrolluar hetimet paraprake pjesë e së cilave janë edhe veprimet e njoftimit të akteve të prokurorit, ligji ia ka ngarkuar prokurorit. Për këto arsye, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk kanë bazë ligjore dhe nuk janë bindëse.

Komisioni arrin në përfundimin se:

- a) Subjekti ka tejkalluar afatet e marrjes së vendimeve të përcaktuara në udhëzimin nr. ***, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar.
- b) Vendimi i mosfillimit është nxjerrë 5 ditë përpara se ankuesi të tërhiqte ankimin, për rrjedhojë, subjekti rezulton se nuk e ka argumentuar vendimin e mosfillimit të procedimit penal.
- c) Vendimi datë 10.7.2015, “Për mosfillim të procedimit penal” i është komunikuar ankuesit, në tejkallim të afatit të parashikuar nga neni 291/1 Kodit të Procedurës Penale.

Dosja nr. 2 – procedimi penal nr. *, datë 15.2.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë,** regjistruar për veprën penale “vjedhje” (neni 134 i Kodit Penal), pushuar në datën 28.7.2016.

2.1. Prokuroria ka regjistruar në datën 15.2.2016 procedimin penal nr. *** për veprën penale “vjedhje” (neni 134 i Kodit Penal). Materiali është referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Vlorë, ku në datën 7.2.2016 është paraqitur shtetasi L. M., i cili ka bërë kallëzim se i janë vjedhur 2 laptopë në zyrën e tij. Sipas procesverbalit datë 8.2.2016, të mbajtur para oficerit të policisë gjyqësore, shtetasi R. Xh. (kolegu i tij i zyrës) deklaroi se 2

laptopët i ka marrë ai në darkë për të punuar në shtëpi, por nuk ka mundur të njoftojë kolegun L. M. sepse e kishte telefonin të fikur.

2.2. Në datën 7.4.2016, pra 2 muaj pas regjistrimit të procedimit, subjekti ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore. Pasi janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore dhe procedurale, në datën 28.7.2016 prokurori, në bazë të nenit 328 pikat 1b, 1d të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur pushimin e çështjes sepse fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe ekziston një shkak që nuk lejon ushtrimin e ndjekjes penale. Procedimi ka zgjatur 5 muaj.

2.3. KLP-ja, në raportin e saj konstaton se në vendimin për pushimin e çështjes, prokurori (subjekti i rivlerësimit) është kontradiktor në arsyetimin e tij kur citon se: *“Nga rrethanat e faktit mungojnë elementët e veprës penale të vjedhjes, parashikuar në nenin 134 Kodit Penal dhe njëkohësisht arsyetoni edhe rrethana që lidhen me heqjen dorë vullnetare nga kryerja e veprës penale”*. Arsyetimi i saktë do të ishte *mungesa e elementëve të veprës penale*, pasi nga rrethanat e parashtruara mungon si ana objektive, ashtu edhe ana subjektive për kryerjen e vjedhjes. Si bazë ligjore për pushimin e çështjes duhet të ishte përdorur neni 328/1, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale.

2.4. Komisioni ka konstatuar se:

- a) Vendimi i pushimit nuk është plotësisht i arsyetuar dhe baza ligjore në vendim nuk është referuar saktë.
- b) Subjekti ka vonuar kryerjen e veprimeve hetimore, duke mos marrë në konsideratë edhe deklarin e datës 8.2.2016, të shtetasit R. Xh., për rrjedhojë, ai ka zvarritur pa shkak këtë procedim.
- c) Në dosje mungojnë vendimet e prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimit në zbatim të neneve 323, 324 të Kodit të Procedurës Penale, për sa kohë që procedimi ka zgjatur 5 muaj që nga data e regjistrimit.
- ç) Vendimi datë 28.7.2016, “Për pushimin e çështjes” i është komunikuar kallëzuesit në datën 20.9.2016, në tejkallim të afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 328/2 i Kodit të Procedurës Penale.

Për konstatimin e mësipërm, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin E të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimet e Komisionit

2.5. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, nuk ka dhënë shpjegime lidhur me konstatimet e mësipërme. Subjekti ka dhënë shpjegime vetëm në seancën dëgjimore të datës 5.7.2021, duke shpjeguar se *në lidhje me pikën ku thuhet që arsyetimi më i saktë do të ishte “mungesa e elementëve të veprës penale”, subjekti i qëndron idesë që jemi para institutit të heqjes dorë nga kryerja e veprës penale, sepse personi që dyshohej për vjedhje e ka marrë në telefon kolegun por ka qenë i fikur dhe personi ka qenë pa masë sigurimi, pra, nuk ishte e domosdoshme që të merrej vendim për zgjatje afati hetimi, pra janë gjykuar në gjendje të lirë, thjesht të dyshuar*. Në lidhje me konstatimin e pikës ç) subjekti ka shpjeguar se *nuk është detyra e prokurorit që të njoftojë ankuesin sepse prokurori e dorëzon vendimin në sekretari, ashtu siç bën gjyqtari, ka ftues gjyqësor dhe sekretari gjyqësor e cila merret me njoftimin e palëve*.

Vlerësimi i Komisionit

2.6. Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse. Subjekti sërish bën arsyetim kontradiktor, duke cituar gjatë shpjegimit se jemi para institutit të heqjes dorë nga kryerja e veprës penale sepse personi i cili dyshohej për vjedhje e ka marrë në telefon kolegun i cili ka qenë i fikur. Në rastin e heqjes dorë nga vepra penale, ekzistojnë elementët e kësaj vepre (pra ka vepër penale) dhe i dyshuari heq dorë nga vepra penale, kurse në rastin objekt hetimi, nuk ka pasur vepër penale, sepse siç citon vetë subjekti, dhe sipas rrethanave të ngjarjes të përshkruara më lart, i dyshuari i ka marrë sendet për të punuar në shtëpi dhe nuk ka mundur të njoftojë kolegun për shkak se ky i fundit e ka pasur telefonin të fikur.

2.7. Në lidhje me shpjegimin e subjektit se *personat kanë qenë pa masë sigurimi, pra janë gjykuar në gjendje të lirë, thjesht të dyshuar dhe nuk ishte e domosdoshme që të merrej vendim për zgjatje afati hetimi*, nuk ka bazë ligjore, sepse neni 324 i Kodit të Procedurës Penale parashikon shtyrjen e afatit të hetimit në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar brenda afatit të caktuar dhe se zgjatja e këtij afati bëhet vetëm me vendim.

2.8. Në lidhje me shpjegimin e subjektit rreth konstatimit të pikës ç) se nuk është detyra e prokurorit që të njoftojë ankuesin, në interpretim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, neni 134, pika 1 që përcakton se: *“Njoftimi i akteve të prokurorit gjatë hetimeve paraprake, bëhet nga policia gjyqësore ose nëpërmjet shërbimit postar...; neni 24 që përcakton se prokurori ushtron ndjekjen penale, bën hetime, kontrollon hetimet paraprake, ngre akuzë në gjykatë dhe merr masa për ekzekutimin e vendimeve në përputhje me rregullat e caktuara në këtë Kod; neni 277, pika 2 që përcakton se: “Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore; rezulton se detyrën e njoftimit të akteve të prokurorit ligji ia ka ngarkuar oficerit të policisë gjyqësore dhe detyrën për të kontrolluar hetimet paraprake pjesë e së cilave janë edhe veprimet e njoftimit të akteve të prokurorit, ligji ia ka ngarkuar prokurorit. Për këto arsye, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk kanë bazë ligjore dhe nuk janë bindëse.*

Komisioni, në lidhje me procedimi penal nr. *, datë 15.2.2016, arrin në përfundimin se:**

- a) Vendimi i pushimit nuk është plotësisht i arsyetuar dhe baza ligjore në vendim nuk është referuar saktë.
- b) Subjekti ka vonuar kryerjen e veprimeve hetimore dhe ka zvarritur pa shkak këtë procedim.
- c) Në dosje mungojnë vendimet e prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimit në zbatim të neneve 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale.
- ç) Vendimi datë 28.7.2016, “Për pushimin e çështjes” i është komunikuar kallëzuesit, në tejkallim të afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 328/2 Kodit të Procedurës Penale.

Dosja nr. 3 – procedimi penal nr. *, datë 10.2.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë,** regjistruar për veprën penale “përdorim me keqdashje të thirrjeve telefonike” (neni 275 i Kodit Penal), pushuar në datën 2.3.2016.

3.1. Prokuroria ka regjistruar në datën 10.2.2016 procedimin penal nr. *** për veprën penale “përdorim me keqdashje të thirrjeve telefonike” (neni 275 i Kodit Penal). Në Komisariatit e Policisë Vlorë, shtetasja M.M. ka bërë në datën 14.1.2016 kallëzimin se në telefonin e saj është shqetësuar nga persona dhe numra të panjohur. Në datën 1.3.2016 ankuesja heq dorë nga ankimi. Në datën 2.3.2016 prokurori ka vendosur pushimin e çështjes dhe vendimin ia ka njoftuar shtetasit M. M. në datën 4.5.2016.

3.2. Komisioni ka konstatuar se vendimi datë 28.7.2016 i është komunikuar personit që ka bërë kallëzimin në datën 4.5.2016, në tejkalim të afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 328/2 i Kodit të Procedurës Penale.

Për konstatimin e mësipërm, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin E të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimin e Komisionit

3.3. Në lidhje me konstatimin e Komisionit, subjekti ka shpjeguar se *nuk është detyra e prokurorit që të njoftojë ankuesin sepse prokurori e dorëzon vendimin në sekretari, ashtu siç bën gjyqtari, ka fues gjyqësor dhe sekretari gjyqësore e cila merret me njoftimin e palëve.*

Vlerësimi i Komisionit

3.4. Komisioni, në lidhje me këtë konstatim, mban të njëjtin qëndrim si më lart, duke vlerësuar se ligji ia ka ngarkuar prokurorit njoftimin e vendimeve.

Komisioni ka arritur në përfundimin se vendimi datë 28.7.2016, i është komunikuar personit që ka bërë kallëzimin në datën 4.5.2016, në tejkalim të afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 328/2 Kodit të Procedurës Penale.

Dosja nr. 4 – procedimi penal nr. *, datë 20.4.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë,** dërguar për gjykim, në ngarkim të të pandehurit V.C., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt” (neni 291 i Kodit Penal).

Dosja nr. 5 – procedimi penal nr. *, datë 10.4.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë,** dërguar për gjykim në ngarkim të të pandehurit M. Zh., akuzuar për kryerjen e veprës penale “lidhjes e paligjshme të energjisë elektrike” (neni 137/1 i Kodit Penal).

Bazuar në raportin e KLP-së dhe pas administrimit të dokumentacionit nga Komisioni nuk u konstatuan problematika në këto dy dosje.

D. TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLP-së

1. KLP-ja i ka kërkuar⁵³ Prokurorisë së Përgjithshme informacion lidhur me subjektin e rivlerësimit Saimir Smaka nëse ka procedim disiplinor; të dhëna nga agjencitë ligjzbatuese për veprime që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit; të dhëna për kontakte të subjektit me persona të papërshtatshëm; kopje të fashikujve të procedimeve penale të mosfilluara, të pushuara apo të pezulluara ku përmendet subjekti i rivlerësimit.

2. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda konfirmon⁵⁴ se pranë kësaj prokurorie ka *indicie* për përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprën penale “korrupsion pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, sipas nenit 319 të Kodit të Procedurës Penale për të cilin po vazhdojnë hetimet.

⁵³ Shkresë nr. *** prot., datë 4.10.2019.

⁵⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 15.10.2019.

3. Sipas informacionit nga Prokuroria e Përgjithshme⁵⁵, rezulton se gjatë viteve 2006 – 2019 për subjektin e rivlerësimit Saimir Smaka kanë ardhur tri praktika me ankesa nga shtetasit S.M.⁵⁶, M.M.⁵⁷ dhe G.M.⁵⁸.

4. Sipas praktikës nr. ***, shtetasi S.M. ka regjistruar në Prokurorinë e Përgjithshme ankimin lidhur me procedimin penal nr. ***, “mashttrim në dëm të disa personave” dhe “falsifikim i dokumenteve”, procedim që po hetohet nga prokurori Saimir Smaka. Sipas ankimit të ripërsëritur⁵⁹ të shtetasit S.M., ky procedim penal ka si objekt hetimin lidhur me vendimin⁶⁰ e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), për të cilin ankuesi pretendon se është i falsifikuar. Ankuesi S.M. pretendon se këto hetime janë zvarritur prej dy vitesh, pasi prokurori Saimir Smaka nuk kryente veprimet hetimore.

4.1. Prokuroria e Përgjithshme dhe shtetasi S.M. janë informuar nëpërmjet Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Vlorë se procedimi penal nr. *** është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë në datën 18.4.2016. Komisioni, pasi ka administruar⁶¹ fashikullin e procedimin penal nr. ***, dërguar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, vëren se:

4.2. Me urdhër datë 15.5.2014, të subjektit të rivlerësimit, është regjistruar procedimi penal nr. ***, i vitit 2014, në bazë të kallëzimit penal datë 15.5.2014, që disa shtetas kanë bërë kundër shtetasit R. I. për veprën penale “mashttrim” (neni 143 i Kodit Penal).

4.3. Gjatë hetimeve, prokurori ka marrë 4 vendime për zgjatjen e afatit të hetimeve me nga 3 muaj (datë 9.5.2015, datë 9.8.2015, datë 9.11.2015 dhe datë 9.2.2016), me arsyen se çështja ka dinamikë në kërkimin e akteve nga ZRPP, AKKP, ALUIZNI, Bashkia Vlorë, pyetje dëshmitarësh, etj. Në dosje nuk gjenden njoftimet drejtuar të pandehurit dhe kallëzuesve për njohjen me vendimet e shtyrjes së afatit të ankimeve. Në dosje gjenden rreth 30 procesverbale dhe vendime për marrje e sekuestrim provash dhe pyetje dëshmitarësh, si dhe shumë prova shkresore të cilat tregojnë vërtet dinamikën e madhe të hetimit dhe volumin e madh të akteve të administruara nga prokurori.

4.4. Në datën 13.10.2014 është mbajtur nga prokurori akti i parë hetimor “procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale”. Pra, nga data 15.5.2014, kur regjistrohet procedimi penal, deri në datën 13.10.2014, kanë kaluar 5 muaj pa veprime hetimore.

4.5. Në datën 30.6.2015 është mbajtur “procesverbali i pyetjes së ekspertës teknike” që ka bërë aktekspertimin teknik dhe në datën 21.9.2015 është mbajtur “procesverbali për kërkimin e personit që nuk gjendet R. I.”. Pra, nga data 30.6.2015 deri në datën 21.9.2015 janë 3 muaj pa veprime hetimore, edhe pse në datën 9.5.2015 prokurori ka marrë vendim për shtyrje të afatit të hetimeve.

4.6. Në datën 16.12.2015 është mbajtur “procesverbali për kërkimin e personit që nuk gjendet R. I.”. Pra, nga data 21.9.2015 deri në datën 16.12.2015 janë rreth 3 muaj pa veprime hetimore, edhe pse në datën 9.8.2015 prokurori ka marrë vendim për shtyrje afati të hetimeve.

⁵⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 22.10.2019.

⁵⁶ Ankesa nr. ***.

⁵⁷ Ankesa nr. ***.

⁵⁸ Ankesa nr. ***.

⁵⁹ Ankesa datë 19.4.2016.

⁶⁰ Vendimi nr. ***, datë 25.6.2009, AKKP-së.

⁶¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 31.5.2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

4.7. Në datën 18.4.2016 prokurori i drejton Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë kërkesën për gjykimin e çështjes në ngarkim të pandehurit R. I. akuzuar për veprat penale “mashtrim në dëm të disa personave” dhe “falsifikim i dokumenteve” (nenet 143/2 dhe 186/1 të Kodit Penal). Pra, nga data 15.5.2014 e regjistrimit të procedimit penal deri në datën 18.4.2016, kur prokurori i ka drejtuar gjykatës kërkesën për gjykim, hetimet kanë zgjatur 23 muaj. Në total rezultojnë rreth 11 muaj pa veprime hetimore.

4.8. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

a) Subjekti ka zvarritur hetimet paraprake pa pasur arsye ligjore.

b) Vendimet për shtyrjen e afatit të hetimit nuk i janë njoftuar të pandehurit dhe kallëzuesit, sipas përcaktimit të nenit 324, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale.

Për konstatimet e mësipërm, subjektit iu kërkuan shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin E të Aneksit të Kushtetutës, por nuk ka dhënë as shpjegime dhe as prova.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me konstatimet e Komisionit

4.9. Subjekti ka dhënë shpjegime vetëm në seancën dëgjimore të datës 5.7.2021. Lidhur me konstatimin e pikës a) se hetimet paraprake janë zvarritur pa pasur arsye ligjore, subjekti ka shpjeguar duke pranuar se ka tejkalim afatesh, por tejkalimet janë bërë për të kryer të gjitha veprimet hetimore, si dhe ka përmendur pjesën më të madhe të veprimeve hetimore që ka kryer.

4.10. Në lidhje me konstatimin e pikës b) se vendimet për shtyrjen e afatit të hetimit nuk i janë njoftuar të pandehurit dhe kallëzuesit, sipas përcaktimit të nenit 324, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, subjekti në seancën dëgjimore ka shpjeguar se *në lidhje me mosnjoftimin e vendimeve për shtyrje të afatit të hetimeve personit që ka bërë kallëzimin, njoftimet nuk janë punë e prokurorit por e ftuesit gjyqësor, prokurori e dorëzon vendimin në sekretari, ashtu siç bën gjyqtari, ka ftues gjyqësor dhe sekretari gjyqësore e cila merret me njoftimin e palëve.*

4.11. Në lidhje me mosnjoftimin e vendimeve për shtyrje të afatit të hetimeve personit nën hetim, e ka thirrur disa herë personin nën hetim shtetasin R. I. nëpërmjet telefonit dhe ka procesverbal për urdhër për paraqitjeje, por ky shtetas nuk është paraqitur. Gjithashtu i ka dërguar shkresë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, por kjo e fundit nuk e shoqëron dot dhe subjekti ka marrë vendim mosgjetejeje. Në përfundim, subjekti shpjegon se i ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore dhe të gjitha veprimet hetimore ia ka njoftuar personit dhe më vonë avokatit të tij të zgjedhur kryesisht.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

4.12. Në lidhje me shpjegimet e subjektit rreth zvarritjes së hetimeve pa arsye ligjore, Komisioni vlerëson se shpjegimi i subjektit sërish nuk justifikon as tejkalimin e afateve të hetimit dhe as zvarritjen e hetimeve. Subjekti ka kryer vërtet një volum veprimesh hetimore, por periudhat kur ai nuk ka kryer asnjë veprim hetimor janë evidente në dosjen hetimore dhe janë konstatuar qartë nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

4.13. Në lidhje me shpjegimet e subjektit rreth arsyeve pse nuk i ka njoftuar vendimet e shtyrjes së afatit të hetimeve, personit që ka bërë kallëzimin, Komisioni vëren se në lidhje me këtë konstatim mban të njëjtin qëndrim si më lart, duke vlerësuar se ligji ia ka ngarkuar prokurorit njoftimin e vendimeve.

4.14. Në lidhje me shpjegimet e subjektit rreth arsyeve pse nuk i ka njoftuar vendimet e shtyrjes së afatit të hetimeve, personit nën hetim, Komisioni vlerëson se këto shpjegime nuk përputhen me aktet e dosjes dhe konkretisht: procesverbali i parë për mosgjetjen e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime është bërë në datën 21.9.2015, kurse dy vendimet e para për shtyrje të afatit të hetimeve janë në datën 9.5.2015 dhe në datën 9.8.2015. Pra, procesverbali për mosgjetje të personit nën hetim, është administruar nga OPGJ-ja rreth 1 muaj e gjysmë pasi është marrë vendimi i dytë për shtyrje afati të hetimeve. Nga kjo kuptohet se dy vendimet e para janë disponuar në kohën kur personi nën hetim nuk ishte në kërkim dhe mund t'i njoftoheshin vendimet. Pasi subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim mosgjetje të personit nën hetim, i ka caktuar atij një avokat kryesisht dhe vendimet për shtyrje të fatit të hetimeve duhej t'ia njoftonte avokatit (neni 50, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale “*Mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njeh të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen personalisht këtij të fundit*”), por subjekti nuk e ka kryer këtë veprim procedural.

Komisioni arrin në përfundimin se:

- a) Subjekti ka zvarritur hetimet paraprake pa pasur arsye ligjore.
- b) Vendimet për shtyrjen e afatit të hetimit nuk i janë njoftuar të pandehurit dhe kallëzuesit, sipas përcaktimit të nenit 324, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale.

5. Sipas praktikës nr. *, ankuesit M. M. dhe V. M. i janë drejtuar⁶² Prokurorisë së Përgjithshme, duke u ankuar se: “Prokurori Saimir Smaka, në çështjen nr. ***, bën shkelje të jashtëzakonshme duke turpëruar institucionin. Ky prokuror, pasi mbante një çështje në sirtar për mëse 16 muaj, e çon në gjykatë për masë arresti me burg për personin (pa asnjë hetim apo provë shtesë), gjykata me të drejtë e rrëzon kërkesën e tij...”**

5.1. Komisioni ka administruar fashikullin e procedimin penal nr. ***, dërguar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë⁶³. Nga shqyrtimi i dosjes, Komisioni vëren se mbi bazën e kallëzimit penal nr. ***, datë 4.2.2015, është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 21.9.2015, për hetimin e veprës penale “dhunë në familje” neni 130/a/2 i Kodit Penal.

5.2. Komisioni vëren se subjekti për 7 muaj nga data e regjistrimit të kallëzimit, nuk ka kryer asnjë veprim në lidhje me këtë material hetimor, duke mos e regjistruar.

5.3. Në datën 22.10.2015 prokurori dërgon dosjen në polici për veprime që duhet të kryhen brenda datës 22.11.2015. Në datën 25.4.2016 prokurori nxjerr urdhrin për regjistrimin e autorit të veprës penale. Me vendimin nr. ***, datë 28.4.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së prokurorit për vendosjen e masës së sigurimit personal “arrest në burg”. Në dosje nuk ndodhet kërkesa me shkrim e prokurorit drejtuar gjykatës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. Nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë bërë ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 28.4.2016.

5.4. Në dosjen hetimore janë administruar: deklaratimet e viktimës E. M., që pretendon se është goditur me grusht nga babai i tij M. M.; deklaratimet e të pandehurit M. M. dhe të bashkëshortes së tij V. M. që deklarojnë se i pandehuri nuk e ka goditur djalin e tij E. M., por vetëm kanë debatuar në distancë; aktekspertimi mjeko-ligjor datë 30.1.2015, për të dëmtuarin E. M. që evidenton llojin e plagës si dëmtim i kryer me mjete të forta mprehëse dhe shkallën e paaftësisë deri 9 ditë për shkak të goditjes. Nga shqyrtimi i dosjes, Komisioni vëren se përveç sa

⁶² Ankimi nr. ***, datë 24.11.2016.

⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 31.5.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

parashtron gjykata, i pandehuri M. M. në kohën e gjykimit është i moshuar 68 vjeç; në dosje ndodhet dëshmia e penaltetit sipas së cilës i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë; në dosje nuk ka opinione mbi sjelljen jo korrekte të pandehurit në komunitet.

5.5. Nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikojnë rastet dhe disa kritere të veçanta lidhur me caktimin e masës së sigurimit, kurse neni 230 i këtij kodi përcakton kriteret e veçanta për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. Në këndvështrimin e neneve 228 dhe 229, së pari, dyshimi i arsyeshëm dhe i bazuar në prova për kryerjen e veprës penale është kusht i domosdoshëm por jo i mjaftueshëm për caktimin e masës së sigurimit. Duhet të plotësohen edhe kushtet e tjera që përcakton neni 228, të cilat, siç rezulton nga aktet në dosje, nuk ekzistojnë. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk ka mbajtur parasysh kriteret e përcaktuara nga neni 229: “...Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal”. Nga aktet në dosje nuk rezulton që fakti penal të jetë kryer në mënyrë të vazhdueshme apo të përsëritur; personi i dyshuar është në moshë 68 vjeç, nuk ka qenë më parë i dënuar dhe nuk ka të dhëna për sjellje jokorrekte të tij në komunitet.

5.6. Referuar nenit 230 të Kodit të Procedurës Penale vlen të theksohet natyra përjashtimore e masës së sigurimit “arrest në burg”, e cila mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit. Nuk ekzistojnë shkaqe që ky shtetas, për shkak të rrethanave të rastit, të kryejë krime të njëjta apo të të njëjtit lloj për të cilin procedohet, si dhe të dëmtojë marrjen e provave, pasi ka kaluar një periudhë 1 vit e dy muaj nga kryerja e pretenduar e veprës penale. Nuk ekzistojnë shkaqe se ky person paraqiste rrezikshmëri të veçantë.

5.7. Në interpretim të Kushtetutës së Shqipërisë dhe Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, caktimi dhe vazhdimi i zbatimit të masës së sigurimit “arrest në burg” lidhen me garantimin e interesit publik për ushtrimin e ndjekjes penale që nga ana e tij proporcionalisht duhet të justifikohet me zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, pra, me respektimin e të drejtave të njeriut, midis të cilave është edhe e drejta e lirisë së personit, natyra rigorozisht përjashtimore dhe e përkohshme e kufizimit të lirisë së tij.

5.8. Në datën 11.5.2016 subjekti i rivlerësimit i dërgon Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë kërkesën për gjykimin e çështjes. Në përfundim të gjykimit, ai ka kërkuar: (i) gjykimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit M. M. për veprën penale “dhunë në familje” neni 130/a/2 i Kodit Penal; (ii) dënimin e tij me 6 muaj burgim; (iii) pezullimin e dënimit për pjesën e pavuajtur në bazë të nenit 59 të Kodit Penal në vlerësim të gjykatës.

5.9. Me vendimin nr. ***, datë 29.1.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur deklarin e pafajshëm të të pandehurit M. M. Kundër këtij vendimi subjekti ka paraqitur ankim. Vërehet se përmbajtja e ankimit është kopje e pandryshuar e tekstit të konkluzioneve përfundimtare që subjekti ka paraqitur para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe nuk argumenton arsyet pse duhet ndryshuar vendimi nr. ***, datë 29.1.2018, i kësaj gjykate.

5.10. Komisioni ka konstatuar se:

a) Subjekti për 7 muaj nga data e regjistrimit të kallëzimit nuk ka kryer asnjë veprim në lidhje me këtë material hetimor, duke mos e regjistruar. Si rrjedhojë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 287 të Kodit të Procedurës Penale dhe udhëzimin nr. ***, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar.

b) Kërkesa për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” e kërkuar pas 1 vit e 2 muaj nga data e regjistrimit të kallëzimit, nuk është në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

5.11. Në lidhje me konstatimin e pikës a) subjekti ka dhënë shpjegime vetëm në seancën dëgjimore datë 5.7.2021, duke pranuar se ka pasur një kohëzgjatje relativisht të gjatë për shkak të ngarkesës relativisht të madhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe ngarkesës së madhe me çështje që ka pasur si prokuror.

5.12. Në lidhje me konstatimin e pikës b) subjekti ka dhënë shpjegime vetëm në seancën dëgjimore, duke shpjeguar se Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon ndonjë moment kur prokurori do t’i caktojë masë sigurimi personal personit, veç e lë të lirë dhe ai mund ta caktojë fillimisht që në momentin kur e nis si procedim, ose mund t’ia caktojë edhe në fund.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

5.13. Në lidhje me qëndrimin e subjektit rreth konstatimit të pikës a), Komisioni vlerëson se shpjegimet e tij nuk janë bindëse, pasi ai kishte detyrimin ligjor për të regjistruar procedimin në zbatim të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale.

5.14. Në lidhje me qëndrimin e subjektit rreth konstatimit të pikës b), Komisioni vlerëson se shpjegimet e tij nuk janë bindëse. Vërtet nuk ka dispozitë ligjore që përcakton momentin se kur vendoset masa e sigurimit personal, por kriteret që përcaktojnë nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale janë ato që diktojnë edhe kohën kur duhet vendosur masa e sigurimit personal. Në rastin konkret, nisur nga natyra e veprës penale dhe nga kriteret që përcakton neni 228 i Kodit të Procedurës Penale, masa e sigurimit personal “arrest me burg” mund të caktohej në fillim të procedimit ose të mos caktohej fare. Nisur nga provat që janë administruar që në fillim të procesit, nisur nga fakti që nuk ka pasur prova apo zhvillime të tjera gjatë hetimeve, nisur edhe nga kriteret e nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale (përshtatshmëria e secilës masë sigurimi me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret, vazhdimësia, përsëritja e goditjes), nuk kishte shkaqe që masa e sigurimit “arrest në burg” të kërkohej nga subjekti i rivlerësimit, dhe aq më tepër të kërkohej pas 14 muajsh. Nga aktet në dosje nuk rezulton që i pandehuri të jetë person me rrezikshmëri shoqërore të tillë sa që ndaj tij nuk mund të vendosej masë tjetër sigurimi përveç asaj “arrest me burg”.

Komisioni arrin në përfundimin se:

a) Subjekti i rivlerësimit, për 7 muaj nga data e regjistrimit të kallëzimit, nuk ka kryer asnjë veprim në lidhje me këtë material hetimor, duke mos e regjistruar. Si rrjedhojë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 287 të Kodit të Procedurës Penale dhe udhëzimin nr. ***, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm.

b) Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar vendosjen e masës së sigurimit personal pas 14 muajsh nga dita e regjistrimit të kallëzimit penal dhe në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, duke kufizuar kështu në mënyrë të padrejtë lirinë e personit.

6. Sipas praktikës nr. ***, ankuesi G.M. i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme⁶⁴, duke u ankuar se: “...pasi ka bërë kallëzim penal në prokurori për falsifikim dokumentesh spitalore,

⁶⁴ Ankimi nr. ***, datë 20.2.2018.

*prokurori i çështjes Saimir Smaka e ka pushuar çështjen me vendimin nr. ***, datë 30.12.2014, pa bërë hetim. I drejtohem Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, gjykata vendos detyrimin e prokurorit që të bëjë hetim të orientuar në pesë pika. Prokurori e apelon dhe Gjykata Apelit lë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Ka një vit e gjysmë heshtje nga prokurori, kam marrë kontakt me të dhe më tha bëj kërkesë të ma heqin dosjen...”. Prokuroria e Përgjithshme, nga ana e saj, i kërkon Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë që t’i japë zgjidhje ligjore rastit dhe për vendimmarrjen të njoftohet ankuesi.*

6.1. Komisioni ka administruar dosjet e procedimeve penale nr. *** dhe nr. *** të dërguara me shkresë⁶⁵ nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga shqyrtimi i dosjeve rezulton se subjekti i rivlerësimit ka disponuar me dy vendime: vendimi datë 29.10.2014, “Mosfillim i procedimit penal nr. ***”; dhe vendimi datë 28.12.2017, “Pezullim i hetimeve”.

6.2. Lidhur me vendimin datë 29.10.2014, “Mosfillim i procedimit penal nr. ***”, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është regjistruar procedimi penal nr. *** mbi bazën e kallëzimit penal nr. ***, datë 15.5.2014, të shtetasit G. M., i cili pretendon se aktualisht po zhvillohet një proces gjyqësor civil ku ai kërkon nga shtetasi K. G. dëmshpërblim moral e pasuror për dëmin që i ka shkaktuar gjatë një konflikti midis tyre. Nga ana e tij shtetasi K. G. ka paraqitur në procesin gjyqësor një kundërpadi, duke pretenduar se edhe ai është dëmtuar gjatë konfliktit prej shtetasit G. M. Për të provuar këtë shtetasi K. G. ka paraqitur në gjykatë dokumente të falsifikuara prandaj shtetasi K. G. duhet të ndiqet penalisht për veprën penale “falsifikim i dokumenteve shëndetësore”, neni 188 i Kodit Penal, sepse ai nuk ka qenë asnjë ditë i shtruar në spital. Shtetasi G. M. i ka bashkëlidhur kallëzimit të gjithë dokumentet shëndetësore që pretendon se janë falsifikuar dhe përdorur në gjykim nga shtetasi K. G.

6.3. Me vendimin datë 29.10.2014, subjekti i rivlerësimit, pa kryer asnjë veprim procedural hetimor, ka vendosur në bazë të nenit 290/1 të Kodit të Procedurës Penale “Mosfillimin e procedimit penal nr. ***” me arsyetimin se: “Fakti i referuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Duke qenë se akti i ekspertimit është shqyrtuar para gjykatës e cila shqyrton çështjen, është vetëm gjykata ajo që duhet të evidentojë gjatë gjykimit nëse akti i ekspertimit mjeko-ligjor është ose jo i rremë”.

6.4. Kundër vendimit datë 29.10.2014, shtetasi G. M. ka paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke kërkuar shfuqizimin e këtij vendimi. Me vendimin nr. ***, datë 30.3.2015, kjo gjykatë ka vendosur: (i) pranimin e ankimit penal të shtetasit G. M.; (ii) shfuqizimin e vendimit datë 29.10.2014, “Mosfillim i procedimit penal nr. ***” të prokurorit Saimir Smaka; (iii) kryerjen e disa veprimeve procedurale nga prokuroria (pyetje të personave që kanë dijeni për veprën penale); sekuestrim e këqyrje dokumentesh; kryerje të aktekspertimit grafik të dokumenteve...

6.5. Kundër vendimit nr. ***, datë 30.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankim dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 4.5.2016, ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 30.3.2015. Kundër vendimit nr. ***, datë 4.5.2016, ka ushtruar rekurs subjekti i rivlerësimit, duke kërkuar ndryshimin e dy vendimeve gjyqësore dhe rrëzimin e kërkesës së shtetasit G. M. Me vendimin nr. ***, datë 16.3.2017, Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar rekursin e subjektit të rivlerësimit.

6.6. Në ankimin dhe rekursin e tij, subjekti i vlerësimit argumenton se: “Pretendimet e kallëzuesit janë gjykuar disa herë nga gjykata civile e penale të cilat me vendime kanë rrëzuar

⁶⁵ Shkresë nr. ***, datë 7.6.2021.

plotësisht pretendimet e tij. Këto vendime që janë administruar edhe në dosjen gjyqësore, kanë marrë formë të prerë në shkallë të parë e në apel. Këto vendime që janë shprehur për të njëjtat fakte, mbi të njëjtin objekt, me të njëjtat palë, përbëjnë 'gjë të gjykuar'".

6.7. Argumentet që subjekti i rivlerësimit paraqet në ankim dhe rekurs nuk i ka parashtruar në arsyetimin e vendimit të tij datë 29.10.2014, "Mosfillim i procedimit penal nr. ***", madje ai nuk ka paraqitur as vendime gjykatash apo prokurorie që përbëjnë "gjë të gjykuar". Në dosje është administruar vetëm vendimi nr. ***, datë 2.5.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me kërkues shtetasin G. M., me objekt "ankim kundër vendimit të pushimit të procedimit penal datë 14.9.2012, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë", me të cilin kjo gjykatë ka rrëzuar kërkesën e shtetasit G. M. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se gjatë veprimeve hetimore i është nënshtruar ekspertimit vetëm akti mjeko-ligjor që trajton dëmtimet që ka pësuar shtetasi G. M. dhe jo aktet shëndetësore që trajtojnë dëmtimet e pësuar nga shtetasi K. G., për të cilat (këto të fundit) ka disponuar me vendim mosfillimi subjekti i rivlerësimit.

6.8. Në vendimin nr. ***, datë 30.3.2015, me të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë shfuqizon vendimin datë 29.10.2014, "Mosfillim i procedimit penal nr. ***" të subjektit, ajo arsyeton se: *"Në vendimin unifikues penal nr. 2, datë 20.6.2013, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë shprehen se rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thellë. Konstatimi i rrethanave është i lehtë dhe përgjithësisht bëhet para fillimit të procedimit penal. Për këtë mjaftojnë vetëm disa verifikime për të konkluduar në vendimin për mosfillimin e procedimit penal. Në këtë fazë, përveç prokurorit dhe OPGJ-së, si subjekte të procedimit marrin pjesë edhe personi të cilit i atribuohet vepra penale. Nëpërmjet neneve 24 dhe 277 të Kodit të Procedurës Penale, ligjvënësi i ka njohur prokurorit ekskluzivitetin e ushtrimit të ndjekjes penale, realizimit të hetimeve (kryerjen e të gjitha veprimeve të mundshme hetimore), drejtimin dhe kontrollin e hetimeve, disponimin për mosfillim apo pushim të procedimit dhe dërgimin e çështjes për gjykim. Në kallëzimin e tij, G. M. pretendon mundësinë apo potencialin e kryerjes nga K. G. të veprës penale 'falsifikim i dokumenteve shëndetësore' si rezultat i përdorimit të këtyre dokumenteve në një gjykim civil. Gjykata vlerëson se nga ana e organit të akuzës nuk është kryer në mënyrë shteruese dhe ezauruese asnjë veprim procedural për të arritur në përfundimin se fakti penal i pretenduar nga G. M. nuk përbën veprë penale dhe se vërtetësia apo vlefshmëria e dokumenteve shëndetësore si të falsifikuara kanë qenë objekt kontrolli dhe vlerësimi nga gjykata. Në këtë kuptim nuk janë pyetur personat që kanë dijeni për veprën penale, nuk janë këqyrur dhe sekuestruar dokumentet e disponuara nga kallëzuesi, nuk është disponuar me vendim kryerja e aktekspertimit grafik i nënshkrimeve të dokumenteve shëndetësore, etj".*

6.9. Komisioni ka konstatuar se subjekti:

a) Në lidhje me këtë procedim nuk ka kryer veprimet e mëposhtme hetimore:

- i. nuk ka pyetur personat që kanë dijeni për veprën penale;
- ii. nuk ka këqyrur dhe sekuestruar dokumentet e depozituara nga kallëzuesi, i cili pretendon se janë të falsifikuara;
- iii. nuk ka disponuar me vendim kryerjen e aktekspertimit grafik të nënshkrimeve të dokumenteve shëndetësore.

b) Nuk ka administruar në dosje asnjë vendim gjykate për të provuar se rasti konkret i procedimit përbën "gjë të gjykuar".

Për konstatimet e mësipërm në lidhje me dy çështjet për të cilat ka hetuar subjekti i rivlerësimit, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin E të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit

6.10. Në lidhje me konstatimet, subjekti nuk ka dhënë shpjegime dhe prova.

Vlerësimi i Komisionit

6.11. Meqenëse subjekti nuk ka dhënë shpjegime dhe prova për këto konstatime, bazuar në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerëson të dalë në përfundime bazuar në provat që ka disponuar nga dokumentacioni që ka dërguar Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe t'i qëndrojë konstatimeve të bëra gjatë hetimit.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti:

a) Nuk ka kryer veprimet e mëposhtme hetimore:

- i. nuk ka pyetur personat që kanë dijeni për veprën penale;
- ii. nuk ka këqyruar dhe sekuestruar dokumentet e depozituara nga kallëzuesi, i cili pretendon se janë të falsifikuara;
- iii. nuk ka disponuar me vendim kryerjen e aktekspertimit grafik të nënshkrimeve të dokumenteve shëndetësore.

b) Nuk ka administruar në dosje asnjë vendim gjykatë për të provuar se rasti konkret i procedimit përbën “gjë të gjykuar”.

6.12. Lidhur me vendimin datë 28.12.2017, “pezullim i hetimeve”, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi bazën e kallëzimit penal nr. ***, të vitit 2016, të shtetasit G. M., me urdhrin datë 8.6.2016, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, “falsifikim i dokumenteve shëndetësore”, neni 187 i Kodit Penal. Në këtë kallëzim, shtetasi G. M. pretendon të njëjtin fakt si në pikën 6.2. Me urdhrin datë 3.4.2017, subjekti i rivlerësimit urdhëron kryerjen e disa veprimeve hetimore, por nga shqyrtimi i dosjes Komisioni vëren se i vetmi veprim hetimor i kryer është kërkimi i dosjes gjyqësore civile (me palë ndërgjyqëse G. M. dhe K. G.) në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas procesverbalit datë 9.5.2017, ku citohet se dosja nuk u gjet, pasi është në Gjykatën e Lartë.

6.13. Me vendimin datë 11.12.2017, subjekti bashkon procedimin penal nr. ***, me procedimin penal të mëparshëm në një procedim të lidhur nr. ***. Me vendimin datë 28.12.2017, subjekti, bazuar në nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale, vendos “pezullimin e procedimit penal nr. ***” dhe dërgimin e akteve policisë gjyqësore për ndjekje të mëtejshme, për shkakun se autori i veprës penale nuk njihet. Nga përmbajtja e këtij vendimi, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit në pjesën më të madhe parashtron plotësisht të njëjtin arsyetim si në vendimin datë 29.10.2014, “mosfillimin e procedimit penal nr. ***” (pika 6.3 më lart) duke pretenduar se fakti i pretenduar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Më tej, subjekti arsyeton se: “Janë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore dhe nuk është bërë e mundur zbulimi i autorit të veprës penale, edhe pse nga shqyrtimi i dosjes hetimore rezulton që subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime hetimore.

6.14. Komisioni ka konstatuar se:

a) Subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore në lidhje me këtë procedim.

b) Subjekti, për një periudhë të gjatë kohore (nga data 8.6.2016, kur ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. *** deri në datën 3.4.2017, kur ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore, kanë kaluar 10 muaj pa kryer asnjë veprim hetimor) nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, duke zvarritur hetimet pa shkaqe ligjore.

Për konstatimet e mësipërm në lidhje me dy çështjet për të cilat ka hetuar subjekti i rivlerësimit, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin E të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

6.15. Në lidhje me konstatimet, subjekti nuk ka dhënë shpjegime dhe prova.

Vlerësimi i Komisionit

6.16. Meqenëse subjekti nuk ka dhënë shpjegime dhe prova për këto konstatime, bazuar në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerëson të dalë në përfundime bazuar në provat që ka disponuar nga dokumentacioni që ka dërguar Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe t'i qëndrojë konstatimeve të bëra gjatë hetimit.

Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti:

a) Nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore.

b) Për një periudhë të gjatë nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, duke zvarritur hetimet pa shkaqe ligjore.

7. Nga përgjigjet e ardhura nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve të para dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, rezulton se:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë bën me dije⁶⁶ se për subjektin e rivlerësimit Saimir Smaka ka *indicie* për përfshirjen e tij në veprën penale “korrupsion pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, neni 319/ç i Kodit të Procedurës Penale. Në fazën ku ndodhen hetimet, nuk mund të kërkohen më shumë informacione (shiko në vijim, Rubrika “E – Konstatime të tjera”, pika 4).

8. Në lidhje me ankesat e paraqitura pranë prokurorive të rretheve gjyqësore dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda, me shkresë⁶⁷ të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit janë dërguar këto kallëzime penale:

- i. nr. ***, datë 25.5.2015, mosfilluar në datën 23.6.2015;
- ii. nr. ***, datë 3.6.2015, mosfilluar në datën 3.7.2015;
- iii. nr. ***, datë 8.6.2015, mosfilluar në datën 6.11.2015;
- iv. nr. ***, datë 6.10.2015, mosfilluar në datën 6.11.2015;
- v. nr. ***, datë 30.12.2015, mosfilluar në datën 30.1.2016;
- vi. nr. ***, datë 15.3.2019, mosfilluar në datën 28.3.2019.

9. Në lidhje me: (i) kallëzimin penal nr. ***, datë 25.5.2015, nga shtetasi F. M. për veprën penale “shpërdorim detyre”, neni 248 i Kodit Penal, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; (ii) kallëzimin penal nr. ***, nga shtetasi Rr. D. për veprën penale “shpërdorim detyre”, neni 248 i Kodit Penal, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së

⁶⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 15.10.2019.

⁶⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 18.10.2019.

Rrethit Gjyqësor Vlorë; (iii) kallëzimin penal nr. ***, nga shtetasi Rr. D. veprën penale “shpërdorim detyre”, neni 248 i Kodit Penal, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; (iv) kallëzimin penal nr. ***, nga shtetasi F. M. për veprën penale “shpërdorim detyre”, neni 248 i Kodit Penal), regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; (v) kallëzimin penal nr. ***, nga shtetasi F. M. për veprën penale “shpërdorim detyre”, neni 248 i Kodit Penal), regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë – **Komisioni arrin në përfundimin se nuk ka problematikë lidhur me këto kallëzime.**

10. Kallëzimi penal nr. *, nga shtetasi F. M., për veprën penale “shpërdorim detyre”, neni 248 i Kodit Penal, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier**

10.1. Në kallëzimin e tij, shtetasi F. M. pretendon se: *“Drejtuesi i Prokurorisë R. T., prokurori S. Smaka, etj., kanë kryer krimin e gjobvënies ndaj tij. Vlera e dëmit prej 110 milion lekësh që i faturohet atij, ka moton ‘O pronën e familjes M., o burgun, o raprezalje, arrestime, gjenocid deri në eliminim fizik’”. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin datë 6.11.2015, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, bazuar në nenet 290/1/ç dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale.*

10.2. Nga vlerësimi i pretendimeve të kallëzuesit F. M., dokumentacionit në dosje dhe verifikimeve të kryera, është arritur në konkluzionin se kallëzuesi nuk përmend rrethana konkrete në lidhje me faktin e kallëzuar dhe personat e figurës së veprës penale “shpërdorim detyre” apo të ndonjë vepre tjetër penale. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të disponuar, në të njëjtin konkluzion arrin edhe Komisioni.

10.3. Nga shqyrtimi i dosjes, Komisioni vëren se në kallëzimin e tij datë 4.8.2015, shtetasi F. M. pretendon se: (i) në aktekspertizën datë 22.6.2014 për konstatimin e dëmit që i ngarkohet atij, mungon një faqe; (ii) prokurori, subjekt i rivlerësimit, i ka caktuar avokat kryesisht me justifikimin se personi nën hetim nuk gjendet.

10.4. Në lidhje me pretendimin e kallëzuesit se në aktekspertizën datë 22.6.2014, për konstatimin e dëmit që i ngarkohet atij, i mungon një faqe, Komisioni vëren se në dosje ndodhet kjo aktekspertizë e plotë, pa mungesë faqesh.

10.5. Në lidhje me pretendimin e kallëzuesit se prokurori, subjekt i rivlerësimit, i ka caktuar avokat kryesisht me justifikimin se personi nën hetim nuk gjendet, në vendimin datë 26.2.2015, “Për mosgjetjen e personit nën hetim”, subjekti i rivlerësimit citon: *“Për nevoja të përfundimit të hetimeve, nga ana e organit procedues është ftuar personi nën hetim F. M., që të paraqitet në datën 20.2.2015 dhe për njoftimin e kësaj ftese janë ngarkuar shërbimet e policisë gjyqësore...”. Rezulton se në dosje nuk gjendet kjo ftesë. Për gjetjen e personit F. M. në dosje gjenden vetëm dy procesverbale datë 23.2.2015 dhe datë 25.2.2015, të mbajtur nga dy oficerë të policisë gjyqësore, të cilët deklarojnë se: “Shtetasi F. M. u kërkua në banesën e tij, por ajo ishte e mbyllur. U kërkua në ambientet ku mendohej se ky shtetas frekuenton dhe nuk u gjend”.*

10.6. Neni 134, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale përcakton se: *“Njoftimi i akteve të prokurorit gjatë hetimeve paraprake, bëhet nga policia gjyqësore ose nëpërmjet shërbimit postar, në format e parashikuara nga neni 133”.* Neni 141 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se: *“Kur njoftimi nuk mund të bëhet sipas rregullave të caktuara për njoftimin e të pandehurit të lirë, autoriteti procedues urdhëron kërkimin e të pandehurit. Në qoftë se kërkimi*

nuk jep rezultat pozitiv, atëherë nxirret vendimi i mosgjetyes, me të cilin, pasi i caktohet një mbrojtës të pandehurit....”.

10.7. Përveç sa më sipër, Komisioni, gjatë shqyrtimit të dosjes, vëren se në datën 21.1.2015 shtetasi F. M. i ka bërë kërkesë subjektivit të rivlerësimit që t'i vërë në dispozicion kopje të dosjes hetimore. Me vendimin datë 4.4.2015, subjekti, bazuar në nenin 110/2 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se çështja është në fazën e gjykimit dhe për këtë duhet të shprehet gjykata. Neni 110/2 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se: *“Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim. Organi procedues shprehet me vendim brenda 15 ditëve”.* Nisur nga përmbajtja e kërkesës, shtetasi F. K. ka kërkuar kopje të dosjes hetimore, pra të dosjes që përmban veprimet e kryera nga prokuroria. Neni 105 i Kodit të Procedurës Penale “Marrja e kopjeve, ekstrakteve dhe vërtetimeve”, përcakton se: *“1. Gjatë procedimit dhe pas përfundimit të tij, cilido që ka interes mund të marrë, me shpenzimet e veta, kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta... 2. Kërkesa shqyrtohet nga prokurori, për aktet e hetimit paraprak ose nga gjykata që ka dhënë vendimin për ato të shqyrtimit gjyqësor”.*

10.8. Komisioni ka konstatuar se:

a) Subjekti nuk ka zbatuar nenet 133 - 141 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me njoftimin e akteve të shtetasit F. M.

b) Subjekti, duke vepruar në kundërshtim me nenet 105 dhe 110/2 të Kodit të Procedurës Penale ka cenuar të drejtën e shtetasit F. M. për t'u njohur me dosjen hetimore.

10.9. Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektivit të rivlerësimit iu ngarkua barra e provës për të dhënë argumentet shoqëruar me provat shkresore, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, dhe nenin E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Qëndrimi i subjektivit të rivlerësimit

10.10. Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjekti ka dhënë shpjegime vetëm në seancën dëgjimore, duke shpjeguar se e ka çuar personin F. M. në gjyq dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e ka dënuar me 9 muaj burg.

Vlerësimi i Komisionit

10.11. Komisioni vlerëson se shpjegimet që ka dhënë subjekti nuk kanë lidhje me konstatimet e Komisionit dhe nuk jep asnjë shpjegim konkret për të provuar të kundërtën e konstatimeve.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit:

a) Nuk ka zbatuar nenet 133 - 141 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me njoftimin e akteve të shtetasit F. M.

b) Ka cenuar të drejtën e shtetasit F. M. për t'u njohur me dosjen hetimore, duke vepruar në kundërshtim me nenet 105 dhe 110/2 të Kodit të Procedurës Penale.

E. KONSTATIME TË TJERA

1. Komisioni, nisur nga disa *indicie* të tjera/*indicie* nga organet ligjzbatuese, për sa i përket aspektit profesional, të cilat, siç është shpjeguar, janë të klasifikuara dhe nuk mund t'i vireshin në dispozicion subjektivit bazuar edhe në qëndrimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në vendimin Regner kundër Republikës Çeke ka konsideruar të arsyeshme të kryejë

hetime të mëtejshme për verifikimin e disa çështjeve gjyqësore penale, duke zgjeruar hetimin në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit, duke administruar dhe dosje të tjera përveç 5 dosjeve të përzgjedhura me short në bazë të nenit 41/4 të ligjit nr. 84/2016.

2. Komisioni i ka kërkuar⁶⁸ Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë fashikujt e dosjeve në ngarkim të të pandehurve Sh.B., E.D. dhe F.K. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me shkresën nr. ***, datë 18.5.2021, ka dërguar në Komision kopje të këtyre dy dosjeve.

3. Nga të dhënat e dosjes së procedimit penal nr. ***, për veprën penale “prodhim e mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit” dhe “kanosje” (nenet 278/1 dhe 84 Kodit Penal) në ngarkim të të pandehurit Sh.B., rezultoi se prokuror i çështjes nuk ka qenë subjekti i rivlerësimit Saimir Smaka, por prokurori A.Z.

4. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 1.6.2021, ka dërguar pranë Komisionit dosjen gjyqësore të procedimit penal nr. ***, të vitit 2017, në ngarkim të të të pandehurve E. D. dhe F. K.

4.1. Nga shqyrtimi i dosjes, Komisioni vëren se në datën 24.11.2017 është regjistruar procedimi penal nr. ***, për veprën penale “prodhim e shitje të lëndëve narkotike”, neni 283/2 i Kodit Penal.

4.2. Sipas procesverbalit datë 23.11.2017, të kapjes në flagrancë dhe sipas informacionit datë 23.11.2017, për referim të veprës penale, rezulton se në datën 23.11.2017 janë kapur në flagrancë shtetasit E. D., F. K. dhe M. S. për kryerjen e veprës penale “prodhim e shitje lëndësh narkotike”, sipas neneve 283/1 dhe 283/2 të Kodit Penal. Është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasve E. D. dhe F. K. (të dy të dënuar më parë) dhe ndjekje në gjendje të lirë për shtetasin M. S. (i padënuar më parë).

4.3. Gjatë arrestimit në flagrancë, është kapur shtetasi E. D., duke i shitur shtetasit M. S. një dozë heroinë që iu gjet, i cili deklaroi se e ka blerë për përdorim vetjak tek shtetasi E. D., kurse këtij të fundit iu gjetën 12 qese plastmasi me doza heroine në xhepin e xhupit. Shtetasi E. D. deklaroi në procesverbalin e kontrollit të banesës datë 23.11.2017, se *dozat që ju gjetën në xhep i ka blerë nga F. K., për t'i shitur sepse është i papunë e është edhe përdorues*. Nga kontrolli i banesës së shtetasit E. D. nuk u gjetën doza të tjera lëndë narkotike dhe as sende të tjera që lidhen me to. Nga kontrolli i banesës së shtetasit F. K. është gjetur një qese e madhe me pluhur heroine, një sasi materiali bimor me ngjyrë jeshile *canabis sativa*, një sërë medikamentesh mjekësore dhe një qese tjetër me 12 doza heroine në qese të vogla plastmasi. Në procesverbalin e datës 23.11.2017, “Për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime, shtetasi F. K. deklaroi se *lënda narkotike që iu gjet e ka për përdorim vetjak dhe një pjesë për ta shitur tek përdoruesit e tjerë*. Të dy shtetasit E. D. dhe F. K. e kanë pranuar kryerjen e veprës penale dhe kanë kërkuar gjykim të shkurtuar.

4.4. Me procesverbalin e përgjimit ambiantal datë 24.11.2017, janë përgjuar dy të personat E. D. dhe F. K. në dialog me njëri-tjetrin në ambientet e brendshme të Policisë Vlorë. Disa nga bisedat e fiksuara në procesverbal janë: “E. D. – Na kanë kapur me fotografi ore, unë tek ty e ti tek mua se kemi marrë gjëra. F. K. – E më plasi mua.... Burgu për burrat është. E. D. – E di që jemi për burg ore po të them. F. K. – Më plasi mua, ti je budalla, burg është ore. E. D. – Martinin e kapën lart. U futën brenda në shtëpi dhe më treguan fotot, ja ku je, ku ke vajtur, ku

⁶⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 11.5.2021.

s'ke vajtur, kë ke takuar, kë s'ke takuar, ça ke dhënë e ça s'ke dhënë. F. K. – Epo ja do t'i shikoj, le të m'i tregojnë mua, më plasi mua ça thonë ata, burgun unë e kam provuar”.

4.5. Sipas tri aktekspertimeve datë 15.1.2018, rezulton se lënda që iu sekuestrua shtetasit E. D. është heroinë (2 gr) dhe lënda që iu sekuestrua shtetasit F. K. është heroinë e krijuar nga përzierja e *canabis sativa* me paracetamol dhe heroinë (5 gr). Sipas aktekspertimeve toksikologjike datë 8.12.2017, rezulton se tre të arrestuarit kanë në trupin e tyre gjurmë lënde narkotike.

4.6. Subjekti i rivlerësimit, me kërkesën datë 24.11.2017, i kërkon gjykatës vlerësimin e arrestit në flagrancë dhe caktim mase sigurimi personal “arrest në burg” për shtetasit F. K. dhe E. D. Në kërkesë, subjekti i rivlerësimit citon *se personat E. D. dhe F. K. dyshohen për kryerje të veprës penale “prodhim e shitje lëndësh narkotike”, neni 283/2 i Kodit Penal*, pra vepër penale në bashkëpunim. Me vendimin nr. ***, datë 25.11.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë cakton masën e sigurimit personal “arrest në burg” për shtetasit E. D. dhe F. K. dhe ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 20.12.2017.

4.7. Në datën 3.1.2018 subjekti i rivlerësimit i kërkon sërish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë caktim masë sigurimi personal “arrest në burg” për dy shtetasit F. K. dhe E. D. Në kërkesë, prokurori citon sërish *se personat E. D. dhe F. K. dyshohen për kryerje të veprës penale “prodhim e shitje lëndësh narkotike”, neni 283/2 i Kodit Penal*, pra vepër në bashkëpunim.

4.8. Në datën 2.2.2018, subjekti i rivlerësimit i kërkon sërish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë caktim mase sigurimi personal “arrest në burg” për shtetasit E. D., kurse për shtetasin F. K. kërkon “detyrim për paraqitje”, por pa cituar ndonjë rrethanë apo provë të re që përbën ndryshimin midis dy të arrestuarve. Edhe në këtë kërkesë, prokurori citon *se personat E. D. dhe F. K. dyshohen për kryerje të veprës penale “prodhim e shitje lëndësh narkotike”, neni 283/2 i Kodit Penal*, pra vepër penale në bashkëpunim. Në kërkesë, subjekti i rivlerësimit citon se të dy të pandehurit janë të dënuar më parë. Në dosje nuk gjendet dëshmi penaliteti për shtetasin E. D., por vetëm për shtetasin F. K. (i padënuar), e cila mban datën 24.4.2018, pra 2 muaj e gjysmë pasi subjekti i rivlerësimit ka bërë kërkesën e tretë për masë sigurimi.

4.9. Në kërkesën datë 2.2.2018, për caktimin e masës së sigurimit, subjekti ka argumentuar dhe konkluduar *se nga të dhënat dhe deklaratimet e cituara në kërkesë, mbështetet ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm se shtetasit F. K. dhe E. D. janë autorë të veprës penale “prodhimi e shitje e lëndëve narkotike”, të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit të Procedurës Penale*. Subjekti vijon duke deklaruar *se të gjitha rrethanat e bëjnë të domosdoshme dhe në përputhje me nevojat e sigurimit caktimin ndaj shtetasve E. D. dhe F. K. të masës së sigurimit “arrest në burg”, që parashikohet nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale*.

4.10. Subjekti i rivlerësimit, pavarësisht argumentimit të mësipërm, në përfundim kërkon caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për shtetasin E. D. dhe caktimin e masës së sigurimit “detyrim për paraqitje” për shtetasin F. K. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 6.2.2018, vendosi për shtetasin E. D. masën e sigurimit personal arrest në burg”, kurse për shtetasin F. K. “detyrim për paraqitje” dhe lirim të tij. Me urdhrin datë 6.2.2018, subjekti i rivlerësimit urdhëron ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. ***, datë 6.2.2018.

4.11. Komisioni ka konstatuar se kërkesa për caktimin e masës së sigurimit “detyrim për paraqitje” për shtetasin F. K. nuk është e argumentuar dhe bie në kundërshtim me vetë argumentet e paraqitura nga subjekti në pjesën arsyetuese të kërkesës për caktimin e masës së

sigurimit. Në zbutjen e masës së sigurimit për njërin nga të pandehurit, subjekti i rivlerësimit nuk ka mbajtur parasysh nenin 260, pika 1 dhe 2 e Kodit të Procedurës Penale.

Për konstatimin e mësipërm, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin E të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimin e Komisionit

4.12. Subjektit nuk ka dhënë shpjegime rreth konstatimit të Komisionit. I pyetur nga Komisioni gjatë seancës dëgjimore mbi arsyet përse nuk ka dhënë shpjegime, subjekti i rivlerësimit deklaroi se shpjegimet do t'i paraqesë në seancë.

4.13. Në seancë, subjekti shpjegoi se në kërkesat e tij për masë sigurimi “detyrim për paraqitje” për shtetasin F. K. dhe “arrest në burg” për shtetasin E. D. nuk ka ndonjë problematikë sepse sasia e lëndës narkotike është e vogël dhe madje mund të ishte në kufijtë e pushimit të çështjes. Në vijim, subjekti shpjegon se sasia e lëndës narkotike është e vogël, nuk mendon se përbën ndonjë rrezikshmëri të madhe pse ai kërkoi masën e sigurimit “detyrim për paraqitje” për njërin dhe “arrest në burg” për tjetrin, madje Prokuroria e Rrethit Vlorë ka praktikë që çështjet me sasi lënde narkotike deri në 3 gram i pushon.

4.14. Pyetjes që trupi gjykues i bëri subjektit në seancë, se a ka një përcaktim ligjor për sasinë e lëndës narkotike, subjekti shpjegoi se kjo mbetet për t'u caktuar rast pas rasti, bazuar edhe në aktekspertimet kimike e toksikologjike lidhur me llojin e lëndës narkotike dhe nëse personi është ose jo përdorues. Pyetjes se cili është limiti sipas vendimeve unifikuese, subjekti iu përgjigj se ato nuk përcaktojnë një limit, por ai vetë është i parimit që për masa të caktuara lënde narkotike kur është lënde narkotike e tipit *cannabis sativa*.... Pyetjes së trupit gjykues se a ka masë përcaktuese edhe për përzierjen, subjekti iu përgjigj që nuk ka.

4.15. Në seancë, subjektit iu drejtua pyetja se cila ka qenë arsyeja që ai ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm ndaj dy të pandehurve, një qasje më të butë ndaj njërit dhe më të rëndë ndaj tjetrit, në kushtet kur shtetasi F. K. ishte personi që prodhonte dhe shiste lëndën narkotike dhe në banesë iu gjetën një qese e madhe me heroinë, një sasi materiali bimor dhe një qese tjetër me 12 doza heroine në qese të vogla, kurse shtetasi E. D., që ishte shitës shpërndarës i lëndëve narkotike, iu gjetën 12 doza të vogla heroine.

4.16. Subjekti shpjegoi se në përcaktimin e masës së sigurimit është nisur nga personaliteti i secilit të pandehur, pasi shtetasi E. D., për të cilin kërkoi masën e sigurimit “arrest në burg” ka qenë më parë i dënuar për këtë vepër penale, kurse shtetasi F. K. ka kërkuar masën “detyrim për paraqitje” sepse nuk ka qenë i dënuar më parë për këtë vepër penale, për ndonjë vepër tjetër ndoshta.

Vlerësimi i Komisionit në lidhje me këto shpjegime

4.17. Shpjegimin e tij se nuk ka ndonjë problematikë meqë sasia e lëndës narkotike është e vogël dhe madje mund të ishte në kufijtë e pushimit të çështjes, subjekti nuk e bazoi në ndonjë dispozitë ligjore, por as në provat që ka dosja. Kriteri (sasia e lëndës narkotike e gjetur) që referon subjekti i rivlerësimit, nuk është një kriter në kuptim të nenit 260, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, aq më tepër që kjo sasi është fiksuar në momentin e kapjes në flagrancë, nuk ka ndryshuar dhe për këtë nuk ka ndikuar në nevojën për zbutjen e mëvonshme të masës së sigurimit. Gjithashtu, edhe rrethanat e faktit deri në atë moment të hetimeve nuk kanë

ndryshuar dhe, si rrjedhojë, nuk kanë diktuar nevojën për zbutje të masës së sigurimit. Përkundrazi, nga përgjimi ambiantal i dy të pandehurve, në fjalët e shtetasit F. K. duket qartë qëndrimi i tij shpërfillës ndaj ligjit dhe mungesa e frikës ndaj ndëshkimit (me burg), ndërsa nga ana tjetër shtetasi E. D. tregohet shumë i frikësuar. Kjo sjellje është një nga rrethanat që tregon se rrezikshmëria shoqërore e shtetasit F. K. ishte më e madhe në raport me rrezikshmërinë e shtetasit E. D.

4.18. Gjatë hetimit, sipas akteve të dosjes, është provuar se të dy të pandehurit janë përdorues dhe tregtues të lëndës narkotike, të dyve iu gjetën në banesë doza lënde narkotike, si dhe kanë vepruar duke koordinuar veprimet me njëri-tjetrin sepse shtetasi F. K. ia shiste shtetasit E. D. lëndën narkotike dhe ky i fundit ia shiste personave të tjerë. Pra, nisur nga këto rrethana të cilat citohen edhe nga vetë subjekti në kërkesën e tij për caktim mase sigurimi personal, të dy personat nën hetim ishin në situata të barabarta, të cilat nuk diktonin nevojën që subjekti i rivlerësimit të kërkonte masa të ndryshme sigurimi për secilin, madje personit për të cilin prokurori kërkoi masë më të butë sigurimi iu gjetën pajisje e medikamente për prodhimin (nëpërmjet përzierjeve të substancave) dhe peshimin e lëndëve narkotike, si dhe sasi më e madhe lënde narkotike sesa iu gjetën personit për të cilin ai kërkoi “arrest në burg”.

4.19. Me shpjegimin e tij se sasia e lëndës narkotike është e vogël dhe madje mund të ishte në kufijtë e pushimit të çështjes, subjekti i rivlerësimit është përpjekur të minimizojë në maksimum rëndësinë e faktit penal dhe rrezikshmërinë e të pandehurit F. K., por vendimi unifikues nr. 1, datë 27.3.2008, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka përcaktuar qartë se: *“Përdoruesi i lëndëve narkotike, i cili e mban atë jo për përdorim vetiak, qoftë edhe në doza të vogla, kur është shpërndarës i saj në një nga format që parashikon neni 283/1 i Kodit Penal, ka përgjegjësi penale sipas kësaj dispozite”*. Kujtojmë që të pandehurit e kanë pranuar vetë gjatë gjithë hetimit se lëndën narkotike e kanë për përdorim vetjak dhe për ta shitur tek persona të tjerë.

4.20. Gjithashtu, nga dosja rezulton se prokurori nuk ka administruar në cilësinë e provës një konfirmim zyrtar nëse shtetasi E. D. ka qenë ose jo më parë i dënuar, kurse për shtetasin F. K. u gjet në dosje një dëshmi penalteti, e cila është lëshuar 2 muaj e gjysmë pasi subjekti ka bërë kërkesën për masën “detyrim për paraqitje”. Pra, duket qartë se subjekti deri në ditën kur gjykata ka vendosur për masën e sigurimit “detyrim për paraqitje” për shtetasin F. K. nuk ka pasur asnjë informacion zyrtar mbi gjendjen penale për asnjë nga të pandehurit, ndërkohë që në aktet e mëparshme të tij, disa herë ka cituar se personat kanë qenë të dënuar.

Për sa më lart, shpjegimet e subjektit nuk bazohen as në ligj e as në prova, prandaj nuk janë bindëse për Komisionin.

Komisioni arrin në përfundimin së kërkesa për caktimin e masës së sigurimit “detyrim për paraqitje” për shtetasin F. K. nuk është e argumentuar drejt sepse nuk përputhet me pjesën arsyetuese të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit dhe më provat e administruara gjatë hetimit. Në zbutjen e masës së sigurimit për njërin nga të pandehurit, subjekti i rivlerësimit nuk ka mbajtur parasysh nenin 260, pika 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale.

4.21. Në datën 23.4.2018 subjekti i rivlerësimit i drejton gjykatës kërkesë për dërgimin e çështjes për gjykim në ngarkim të shtetasve E. D. dhe F. K. për veprën penale “prodhim e shitje bimësh narkotike”, neni 283/1 i Kodit Penal (pra në kërkesën e prokurorit, subjekt rivlerësimi,

vërehet se ka ndryshuar cilësimi i veprës penale, duke mos e bazuar më në nenin 283/2 të Kodit Penal por në nenin 283/1 të Kodit Penal dhe nuk përfshin kështu “bashkëpunimin” si mënyrë të kryerjes së veprës penale).

4.22. Nga provat e administruar në fashikullin penal rezulton se dy të pandehurit janë përdorues të lëndëve narkotike; të dy njihen me njëri-tjetrin; të dy janë kapur dhe u janë gjetur sasi lëndësh narkotike, madje shtetasit F. K. i janë gjetur edhe mjete për prodhimin e tyre; të dy kanë kryer veprimin e shpërndarjes së lëndëve narkotike (shtetasi F. K. prodhon dhe shet, kurse shtetasi E. D blen nga shtetasi F. K. për të shitur). Pavarësisht nga këto, edhe pse fillimisht për dy të pandehurit është bërë klasifikimi i veprës penale në bashkëpunim sipas nenit 283/2 të Kodit Penal, në kërkesën për gjykim, subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar klasifikimin e veprës penale, duke e bazuar në nenin 283/1 të Kodit Penal, por nuk ka paraqitur për secilin të pandehur asnjë provë ose rrethanë të re apo të ndryshme që nga hetimet e para.

4.23. Komisioni ka konstatuar se ndryshimi i cilësimit të veprës penale nga ana e subjektit nuk është i argumentuar dhe bie në kundërshtim me vetë argumentet e tij të paraqitura në kërkesën për gjykim dhe me provat e administruara gjatë hetimit.

Për konstatimin e mësipërm, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin E të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë konstatim

4.24. Subjekti ka dhënë shpjegime vetëm në seancë dëgjimore, duke shpjeguar se është e vërtetë që është bërë ndryshim i cilësimit juridik, por nuk mund t’i çonte në bashkëpunim, sepse në dosje ka përgjime ambientale në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, nga nuk provohet bashkëpunimi; personat janë arrestuar në vende të ndryshme, janë arrestuar secili në banesën e tij; njëri e shet lëndën narkotike, tjetri e blen dhe e konsumon vetë, dhe se i ka çuar njërin për prodhim shitje dhe tjetrin për qëllim përdorimi personal.

Vlerësimi i Komisionit

4.25. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse. Edhe në shpjegimet e tij subjekti përpiqet që pozitën dhe rrethanat e çështjes për secilin person t’i paraqesë ndryshe nga sa janë pasqyruar në aktet e dosjes, ku duket qartë se personat nën hetim janë të dy së bashku edhe konsumatorë edhe shitës e shpërndarës, si dhe njëri e blen lëndën narkotike tek personi tjetër. Edhe nga përgjimi ambiental i dy personave E. D. dhe F. K., i administruar si provë në dosjen hetimore, provohet qartë se ata njiheshin bashkë dhe kanë kryer së bashku veprime që kanë pasur si qëllim final shpërndarjen dhe tregtimin e lëndës narkotike, madje njëri prej tyre është shumë i shqetësuar sepse i kanë fotografuar së bashku me njëri-tjetrit.

4.26. Nga përmbajtja e dosjes rezulton se janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale dhe hetimore. Është administruar edhe vendimi i arsyetuar, datë 24.2.2018, i subjekti të rivlerësimit për shtyrje afati hetimesh për 3 muaj. Në konkluzionet përfundimtare në gjykim, subjekti i rivlerësimit bën të njëjtin përshkrim rrethanash dhe faktesh, ashtu si edhe në kërkesat për masë sigurimi personal dhe nuk përmend prova apo rrethana të reja e të ndryshme nga njëri-tjetri për 2 të pandehurit. Pavarësisht nga kjo, subjekti i rivlerësimit kërkon për të dy të pandehurit dënimin me 5 vite burgim, por për shtetasin F. K. kërkon pezullimin e ekzekutimit të dënimit penal dhe vënien në provë për 3 vjet, me kusht që të mos kryejë veprë tjetër penale.

4.27. Nga analizimi i dokumentit “konkluzione përfundimtare” në kuadër të procedimit penal nr. ***, rezulton që për të dy të pandehurit subjekti ka konkluduar se *ndodhemi para elementëve të figurës së veprës penale “prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike”*. Në asnjë paragraf të këtij dokumenti nuk rezulton që subjekti të ketë analizuar kriteret e parashikuara nga neni 59, pika 1 e Kodit Penal, për caktimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit dhe vënien në provë të të pandehurit F. K. Subjekti i rivlerësimit ka administruar në dosje dëshmi penaliteti vetëm për shtetasin F. K. dhe jo për shtetasin E. D. Kjo tregon për një vendimmarrje qëllimisht të paarsyetuar nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me kërkimin e llojit dhe masës së dënimit për të pandehurin F. K.

Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka argumentuar kërkesën e tij për pezullimin e ekzekutimit të dënimit penal për shtetasin F. K., duke mos marrë në analizë kushtet e përcaktuara nga neni 59, pika 1 e Kodit Penal.

Për këtë konstatim, Komisioni i ngarkoi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë konstatim

4.28. Subjekti ka shpjeguar se ka mbajtur qëndrim të diferencuar në lidhje me llojin dhe masën e dënimit, nisur nga masa e lëndës narkotike që është shumë e vogël. Në vijim, subjekti shpjegon se, edhe në rast se ai ka gabuar në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të vendimit për njërin nga të pandehurit, vendimi i gjykatës është mëse i drejtë sepse duke i dhënë të dyve pezullim ajo i ka trajtuar në kushte të barabarta dhe në këtë rast gjykata e ka mbrojtur gabimin e prokurorit në qoftë se vërtet ka gabim.

Vlerësimi i Komisionit

4.29. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, sepse, së pari, sipas shpjegimeve kuptohet që edhe për caktimin e diferencuar të llojit dhe masës së dënimit ai i referohet vetëm sasisë së lëndës narkotike dhe sërish nuk referohet në kriteret e nenit 59, pika 1 e Kodit Penal për caktimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit dhe vënien në provë të të pandehurit F. K., kriteret të cilat nuk janë përjashtuese të njëra-tjetrës, por që duhen analizuar së bashku në tërësinë dhe ndërveprim midis tyre. Së dyti, edhe sikur i vetmi kriter që kishte mbetur për të bërë diferencimin midis dy të pandehurve të ishte sasia e lëndës narkotike që iu gjet secilit, lloji dhe masa e dënimit që subjekti ka kërkuar për secilin të pandehur është në raport të zhdrejtë me sasinë e lëndës narkotike që iu gjet secilit prej tyre.

Për sa më lart, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk bazohen në ligj dhe në prova dhe nuk janë bindëse për Komisionin.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar kërkesën e tij për pezullimin e ekzekutimit të dënimit penal për shtetasin F. K., duke mos marrë në analizë kushtet e përcaktuara nga neni 59, pika 1 e Kodit Penal.

4.30. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 12.9.2018, ka vendosur për secilin të pandehur të njëjtat dënime: 1. deklarin fajtor për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”, neni 283/1 i Kodit Penal; 2. në aplikim të nenit 406, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, dënimin me 3 vjet e 4 muaj burgim; 3. në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e mbetur dhe vënien në

provë për 5 vjet... Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore nuk rezulton që prokurori të ketë bërë ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 12.9.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

4.31. Gjatë seancës dëgjimore, trupi gjykues i drejtoi subjektit të rivlerësimit pyetjen përse nuk e ka ankimuar vendimin nr. ***, datë 12.9.2018, në Gjykatën e Apelit. Subjekti ka shpjeguar se pasi është dhënë vendimi, gjyqtarja e çështjes i ka thënë që ai kishte bërë trajtim të diferencuar në lidhje me rastin konkret. Duke çmuar gjithë analizën juridike të provave, fakteve dhe rrethanave që dolën gjatë gjykimit, ka menduar se vendimi i gjykatës ka qenë i drejtë prandaj nuk ka bërë ankim, por gjithashtu ka edhe udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm që përcakton detyrimin e prokurorit për të bërë ankim për rastet kur gjykata jep pafajësi, ndryshon cilësimin juridik që ka vendosur prokurori apo kur gjykata jep masë dënimi më të vogël se ½ e masës që ka kërkuar prokurori, kurse për rastin konkret është në çmimin e prokurorit që të bëjë ose jo ankim.

4.32. Gjatë seancës dëgjimore, trupi gjykues i drejtoi subjektit pyetjen nëse ka kontaktuar ndonjëherë me ndonjë të afërm të dy të pandehurve E. D. dhe F. K., qoftë edhe për efekt të hetimeve. Subjekti ka mohuar në mënyrë të përsëritur disa herë të kishte kontaktuar ndonjërin, por më pas pranoi se i ka pritur në zyrë kur kanë ardhur herën e parë nënën e të pandehurve nga fillimi i shtatorit të vitit 2018, ku ata kanë qenë me masë sigurimi me afat dhe i ka thënë nënave të tyre se do prisni ngaqë nuk kanë ardhur aktet. Më pas ato kanë ardhur prapë në përfundim të hetimeve dhe subjekti i ka shpjeguar se e ka çuar çështjen në gjyq për të dy të pandehurit. Pas shtatorit të vitit 2018 njëra prej këtyre zonjave ka ardhur në ambientet e prokurorisë dhe subjekti i ka thënë këtë gjë, që kjo çështje do shqyrtohet me objektivitet, me paanësi dhe beson se do zgjidhet brenda një afati të arsyeshëm.

4.33. Në vijim, subjektit i është drejtuar pyetja se me çfarë procedure i ka pritur dhe takuar në zyrë familjarët e të pandehurve, a ka pasur dëshmitarë, a ka mbajtur procesverbal takimi apo ndonjë memo zyrtare për të dhe zyrën e Prokurorisë së Rrethit Vlorë mbi këto takime, se çfarë diskutimesh janë bërë në këto takime, çfarë është thënë? Subjekti ka shpjeguar se: “Nuk është mbajtur procesverbal dhe nuk ka pasur persona të tretë, por nënën e të pandehurve janë paraqitur te recepsioni ku punonjësi ka mbajtur shënim në regjistër ID-në e tyre, kohën kur janë paraqitur dhe ka njoftuar se duan të më takojnë. Kjo është praktikë e Prokurorisë së Rrethit Vlorë”. Subjekti shpjegon se i ka pritur në zyrë si gjithë të tjerët dhe nuk ka bërë takime jashtë zyre, në takim u ka thënë që çështja do shkojë në gjyq, brenda afateve procedurale, do merrni masën dhe llojin e dënimit që parashikon kodi, çështjen do ta shikojë me objektivitet dhe pa rënduar pozitën e asnjërit prej tyre. Subjekti shpjegon se mendon që ato mund të kenë ardhur për të parë se çfarë qëndrimi do mbante ai mbi çështjen d.m.th., në kuptimin human apo njerëzor.

Vlerësimi i trupit gjykues në lidhje me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

4.34. Nisur nga qëndrimi i subjektit, fillimisht mohues në mënyrë të përsëritur dhe më pas pranues në lidhje me takimet e zhvilluara me nënën e të pandehurve dhe nisur dhe nga fakti që takimet nuk kanë qenë transparente, Komisioni nuk i konsideron të mjaftueshme dhe bindëse shpjegimet e subjektit lidhur me përmbajtjen e këtyre takimeve.

Komisioni ka arritur në përfundimin se, bazuar në:

- të dhënat e administruara nga organet ligjzbatuese;

- faktin që subjekti i rivlerësimit ka kërkuar për shtetasin F. K. masën e sigurimit “detyrim për paraqitje”, masë e cila është më e butë se ajo e kërkuar për shtetasin E. D. për të njëjtën vepër penale dhe për të njëjtat rrethana;
 - faktin se subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar gjykatës pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për të pandehurin F. K., ndërkohë për të pandehurin E. D. nuk e ka kërkuar një gjë të tillë, pavarësisht se kishim të bënim me të njëjtën vepër penale dhe me të njëjtat rrethana;
 - faktin që subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale, nga vepër e bazuar në nenin 283/2 të Kodit Penal, në vepër të bazuar në nenin 283/1 të Kodit Penal; si dhe
 - faktin që subjekti i rivlerësimit ka mbajtur fillimisht mohues në mënyrë të përsëritur dhe më pas pranues në lidhje me takimet jotransparente të zhvilluara me nënat e të pandehurve,
- **subjekti i rivlerësimit ka favorizuar shtetasin F. K., duke cenuar parimin e një procesi të drejtë dhe të barabartë nëpërmjet moszbatimit të dispozitave penale dhe procedurale penale, me pasojë cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.**

F. DENONCIME NGA PUBLIKU

1. Denoncimi nr. *, datë 27.2.2018, i shtetasit Nj.J. dhe denoncimi nr. ***, datë 15.5.2018, i shtetasit L.M.**

Komisioni, pasi analizoi denoncimet dhe dokumentacionin shoqërues, arriti në përfundimin se nuk paraqiten shkaqe apo rrethana që tregojnë veprime të njëanshme apo shkelje ligjore të kryera nga subjekti i rivlerësimit që mund ta ngarkojnë me përgjegjësi disiplinore në lidhje me kriterin profesional.

2. Denoncimi nr. *, datë 11.1.2018, i shtetasit A.S.**

2.1. Në denoncimin e tij drejtuar Komisionit, shtetasi A.S. denoncon subjektin e rivlerësimit Saimir Smaka dhe pretendon se: *“Prokurori S. Smaka më ka dërguar për gjykim pa prova, por vetëm me thëniet e një personi, i cili u përdor nga të tjerët për të më goditur figurën time. Kur i thashë pse më dërgon në gjykatë pa prova, tha: prano fajin dhe do kërkoj dënim me gjobë 100,000 lekë. Kur mora pafajësinë në shkallë të parë, prokurori e apeloj vendimin në gjykatën e apelit dhe nuk kishte prokuror të merrte përsipër akuzën”.*

2.2. Komisioni administroi fashikullin e dosjes nr. ***, dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë⁶⁹ me shkresë⁷⁰. Nga përmbajtja e kësaj dosjeje, Komisioni vëren se:

2.3. Në datën 10.3.2015 në Komisarriatin e Policisë Vlorë janë paraqitur shtetasit E. M., kallëzuesi, dhe kolegu i tij R. Xh., të dy me detyrë inspektorë tatimorë në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Vlorë. Në datën 7.4.2015 subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “goditje për shkak të detyrës”.

2.4. Në kallëzimin e tyre, sipas dy procesverbaleve datë 10.3.2015, datë 10.3.2016, dhe datë 17.2.2016, shtetasit E. M. dhe R. Xh. deklarojnë se gjatë inspektimit në një subjekt, në ambientet e subjektit, i pandehuri A. S. ka debatuar me shtetasin E. M. sepse i pandehuri donte të detyronte këtë shtetas që të mos ushtronte kontroll tek ai subjekt, meqë subjekti ishte miku i A. S. dhe më pas e ka goditur në dorën e majtë me një levë metali që mbante të mbështjellë me

⁶⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 2.6.2021, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

⁷⁰ Shkresën nr. *** prot., datë 8.6.2021, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

gazetë. Shtetasit E. M dhe R. Xh. kanë deklaruar se shtetasi E. M. është goditur për shkak të ushtrimit të detyrës. I Pandehuri A. S. gjatë hetimit dhe gjatë gjyqimit e ka mohuar që të ketë goditur shtetasin E. M.

2.5. Gjatë hetimit shtetasi E. M. ka deklaruar në procesverbalin datë 10.3.2016, se është pajisur me vendimin për caktim eksperti mjeko-ligjor, por për arsye objektive nuk e ka marrë aktin mjeko-ligjor. Kurse në seancë gjyqësore, shtetasi E. M. ka deklaruar se pas kallëzimit ka shkuar te mjeku ligjor për të bërë vizitën sipas urdhrin të OPGJ-së dhe pas vizitës mjeku i ka thënë të largohet pasi aktin do e dërgojë vetë pranë OPGJ-së. Me shkresën⁷¹ e Institutit të Mjekësisë Ligjore (IML), mjeku K. J. i ngarkuar me vendimin datë 10.3.2015, për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor, citon se shtetasi E. M. nuk është paraqitur për ekzaminim ndaj nuk mund t'i përgjigjet pyetjeve të vendimit.

2.6. Subjekti i rivlerësimit, pasi ka dërguar çështjen për gjykim, bazuar vetëm në deklaratimet e shtetasve E. M., R. Xh. dhe A. S., ka kërkuar dënimin fajtor të shtetasit A. S. për veprën penale “goditje për shkak të detyrës”, neni 237 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me gjobë 300,000 lekë. Në kërkesën për gjykim, subjekti i rivlerësimit citon se *i pandehuri gjatë hetimeve ka mbajtur qëndrim pendues dhe ka dhënë shpjegimet e nevojshme për zbardhjen e hetimit*, por në procesverbalin datë 9.5.2016, i pandehuri A. S. deklaroi vetëm se: *“Nuk e kam goditur shtetasin E. M. por ka qenë një konflikt momental. Më pas marrëdhëniet tona janë normalizuar dhe aktualisht kemi marrëdhënie të mira shoqërore”*.

2.7. Gjatë gjyqimit janë pyetur edhe 2 persona të tjerë, me cilësinë e dëshmitarit në vendngjarje, (pronari i subjektit A. Gj. dhe shtetasi B. H.), të cilët nuk janë pyetur gjatë veprimeve hetimore. Këta persona dëshmuar se nuk e kanë parë shtetasin A. S. të ushtronte dhunë ndaj shtetasit E. M., por vetëm debate verbale.

2.8. Gjatë gjyqimit, shtetasi R. Xh., kolegu i shtetasit E. M., ka deklaruar se nuk ka parë që i pandehuri ta godasë kolegun e tij E. M., sepse ka qenë me kurriz, por vetëm ka dëgjuar debat dhe ka ndërhyrë, duke e nxjerrë të pandehurin A. S. nga lokali. Meqë në gjykim dëshmitari R. Xh. ka deklaruar ndryshe nga sa ka deklaruar gjatë hetimeve, prokurori ka kërkuar në seancë gjyqësore kundërshtimin e pjesshëm të dëshmisë që dha në gjyq dëshmitari R. Xh.

2.9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 27.9.2016, e ka deklaruar të pafajshëm të pandehurin (denoncuesin). Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 7.6.2017, ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 27.09.2016. Gjykatat kanë arsyetuar në vendime se: *“Deklarimet e E. M. në raport dhe analizë më provat e tjera (dëshmitë e 3 dëshmitarëve dhe e të pandehurit, shkresën nr. ***, datë 4.11.2015, të IML-së), janë të pabesueshme dhe të njëanshme. Vepra penale e pretenduar nuk ka ndodhur dhe provat e paraqitura nuk provojnë faktin e pretenduar se A. M. ka goditur E. M. për shkak të detyrës. Në vendimin nr. ***, datë 21.12.2005, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë theksohet se nuk mund të provohet fajësia e një personi të akuzuar vetëm me një provë çfarëdo qoftë ajo edhe nëse është shkresore, nëse nuk ka prova të tjera që e shoqërojnë atë”*.

2.10. Gjithashtu, Komisioni, nga shqyrtimi i dosjes, vëren se nga data 7.4.2015, kur subjekti i rivlerësimit ka vendosur regjistrimin e procedimit penal deri në datën 9.5.2016, kur ka

⁷¹ Shkresë nr. *** prot., datë 4.11.2015, e IML-së.

vendosur dërgimin e çështjes për gjykim, kanë kaluar 13 muaj dhe në dosjen hetimore nuk ka asnjë vendim për shtyrje të afatit të hetimeve të marrë nga subjekti i rivlerësimit.

2.11. Komisioni ka konstatuar se:

a) Subjekti i rivlerësimit e ka ngritur akuzën e tij ndaj shtetasit A. S. dhe ka kërkuar gjykimin e tij, duke u bazuar vetëm në deklaratimet e shtetasve E. M. dhe R. Xh. dhe nuk ka administruar aktin e ekspertizës mjeko-ligjore. Prokurori nuk ka marrë parasysh nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale që përcakton se: *“Çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet, përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën. Deklarimet e bëra nga i bashkëpandehuri në të njëjtën vepër penale ose nga personi i marrë si i pandehur në një procedim që lidhet me të vlerësohen në unitet me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre”.*

b) Subjekti i rivlerësimit ka tejkalluar afatin e hetimeve dhe nuk ka administruar me vendim për shtyrje të këtij afati, sipas nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale.

Për konstatimet e mësipërme, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin E të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit

2.12. Në lidhje me këtë konstatim subjekti ka dhënë shpjegime në prapësimet e tij të dërguara pranë Komisionit. Në lidhje me konstatimin e pikës a) ka shpjeguar se në kushtet kur i dëmtuari nga vepra penale, shtetasi E. M., nuk është paraqitur në IML-në Vlorë, subjekti e ka mbështetur akuzën vetëm tek prova me dëshmitarë. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ka shpjeguar se shtetasi E. M., për arsye objektive, nuk ka shkuar tek IML-ja për të marrë dëshminë mjeko-ligjore dhe në këto kushte ai nuk kishte provë tjetër ku të bazohej (as ngjarjen të fiksuar me kamera, as procesverbal këqyrjeje, as procesverbal marrje prove materiale), përveç dëshmisë për të çuar çështjen në gjyq. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se është e vërtetë që ka njëfarë zgjatje afati, por kjo për efekt të ngarkesës dhe për faktin se fillimisht nuk më është dukur bindës si kallëzim.

2.13. Gjatë seancës dëgjimore, trupi gjykues i ka kërkuar shpjegim subjektit të rivlerësimit lidhur me faktin se gjatë procesit gjyqësor gjykata ka marrë si dëshmitar edhe dy persona të tjerë dhe pse nuk janë thirrur nga subjekti këta dy persona si dëshmitarë.

2.14. Subjekti ka dhënë shpjegime se kur është parashtruar radha e marrjes së provave tek gjyqtari që gjykoi themelin e çështjes, ai ka parashtruar radhën e marrjes së provave dhe ka kërkuar dëshmitarët që ka pasur në hetim. Ndërkohë, mbrojtja ka kërkuar dëshmitarë të tjerë dhe kur është pyetur nga trupi gjykues, subjekti ka thënë që nuk është e domosdoshme të pyeten këta persona, sepse sipas mendimit të tij ata nuk kanë qenë dëshmitarë okularë në vendngjarje. Gjykata ka vendosur t'i pranojë dhe subjekti ka qenë përpara faktit të kryer dhe duhet t'i pyeste edhe ata me cilësinë e dëshmitarëve.

2.15. Subjekti, gjatë seancës dëgjimore, ka dhënë shpjegimeve në lidhje me konstatimin e pikës b), duke kundërshtuar shpjegimet e dhëna pas njohjes me rezultatet e hetimit. Konkretisht, subjekti ka shpjeguar se nuk ka bërë zgjatje afati sepse personi që kishte bërë kallëzimin penal, shtetasi E. M., nuk ka shkuar brenda afatit 5-ditor që parashikon ligji për të marrë raportin mjeko-ligjor. Përgjigja nga mjeku ligjor ka ardhur me vonesë, kështu që nuk mund të

regjistronte emër autori të veprës penale. Në këto kushte, vazhdon shpjegimet subjekti, nuk mund të shprehej për vërtetësinë e dëmtimeve të shtetasit E. M. Shtetasi A. S. është hetuar në gjendje të lirë dhe nuk është proceduar me masë arresti, duke menduar që të bënte më mirë një hetim të plotë dhe objektiv dhe pastaj të vendoste për të bërë regjistrim emri, e më pas të komunikonte zgjatjen e afatit.

Vlerësimi i Komisionit

2.16. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjekti nuk janë të mjaftueshme dhe bindëse, aq më tepër kur pranon vetë se nuk ka pasur mundësi të dispononte asnjë provë tjetër përveç dëshmisë së shtetasve R. Xh. dhe E. M., si dhe pranon që ka zgjatje të afateve të hetimeve për shkak të ngarkesës në punë dhe faktit që ai ende nuk kishte krijuar bindjen në vërtetësinë e kallëzimit. Këto dy shkaqe që përmend subjekti nuk janë shkaqe ligjore për shtyrjen e afatit të hetimeve. Në lidhje me shpjegimet e subjektit për tejkalimin e afatit të hetimeve, Komisioni vlerëson se nuk bazohen as në fakt dhe as në ligj. Nga data 7.4.2015, kur subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal, deri në datën 4.11.2015, kur ka marrë përgjigjen nga IML-ja për moskryerje të aktekspertimit, kanë kaluar 7 muaj pa bërë asnjë lloj veprimi rreth rezultateve të ekspertizës mjeko-ligjore. Akoma më tepër kur nga data 4.11.2015 deri në datën 9.5.2016, kur subjekti ka dërguar çështjen në gjykim, kanë kaluar 6 muaj. Pra, më pas, kur nuk ka qenë më pengesë vonesa e përgjigjes për aktekspertizën mjeko-ligjore, sërish pa arsye ligjore, subjekti ka zvarritur hetimet, duke zgjatur afatin e tyre përtej limiteve ligjore dhe pa disponuar me vendim të arsyetuar për këtë shtyrje.

Komisioni ka arritur në përfundimin se:

Subjekti i rivlerësimit e ka ngritur akuzën e tij ndaj shtetasit A. S. dhe ka kërkuar gjykimin e tij, duke u bazuar vetëm në deklaratimet e shtetasve E. M. dhe R. Xh. dhe nuk ka administruar aktin e ekspertizës mjeko-ligjore. Prokurori nuk ka marrë parasysh nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLP-ja dhe denoncimeve të depozituara në Komision, trupi gjykues vlerëson se të metat e konstatuara në shqyrtimin e procedimeve të mësipërme reflektojnë mangësi profesionale të tilla që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit. Ai ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, vonesa dhe zvarritje të gjykimeve, që çojnë në cenim të të drejtave të palëve. Nga ana e tij në një rast rezultoi se është favorizuar një nga të pandehurit.

Të gjitha këto të meta të konstatuara në vlerësimin profesional të subjektit vlerësohet se cenojnë besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

G. VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

1. Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreu IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim

të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, z. Saimir Smaka:

a. Ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë.

Nga analiza financiare për periudhën 2013 – 2016, rezulton se me të ardhurat e fituara nga punësimi i tij, personave të lidhur me të, ai nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruara në shumën prej 172,731 lekësh.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës prej 1,719,000 lekësh, me të ardhurat nga dhënia me qira e tokës bujqësore, duke rezultuar me balancë financiare negative prej 1,719,000 lekësh.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Saimir Smaka, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

2. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Saimir Smaka, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

3. Trupi gjykues, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, në pikat 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 2, të nenit 4 si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, dhe në bazë të pikës 1/c, pikës 3 të nenit 58 dhe të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Saimir Smaka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 7.7.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

**Kryesuese
Genta Tafa (Bungo)**

**Relator
Olsi Komici**

**Anëtare
Suela Zhegu**

*Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj*